



Vjetar informativ i Departamentit të Antropologjisë
Fakulteti Filozofik, Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina"
Shtator 2020 / Nr. 2



*“Veç një qëllim i naltë t’ban me durue,
E zemrën ta forcon,
Ndër kundërshtime s’vien kurr me u ligshue,
Mjer’ ai që nuk qindron”*

(Luigj Gurakuqi)

LETRA E REDAKSISË

Të nderuar lexues

Viti akademik që kemi lënë pas, na ballafaqoi me pandeminë COVID-19, e cila shpërtheu dhe u shpërnda gjithandej kontinenteve. Botën e zuri gafil dhe e gjunjëzoi para një fakti esencial: shoqëria njerëzore herë pas here kalon nëpër “grykë gastareje”, dhe, kështu, njeriu lëviz apo migron drejt një gjendjeje të re. Si homosapiens, jemi esencialisht qenie evolutive e migruese; njeriu është prore migrant drejt trojeve të reja natyrore e kulturore. Por, cilat do të jenë trojet e reja kulturore në të ardhmen? Nuk dihet saktësisht. Megjithatë, kjo pandemi na tregoi se shumë nga jeta jonë drejt trojeve të reja do të mishërohet me teknologjinë e “realitetit virtual”.

Gjatë kësaj kohe pandemie kanë zënë fill ndryshime të shumta, por edhe plane të shumta për ndryshime në të ardhmen. Në akademi, vetë statusi i universitetit është në rrugë të ndryshimit dhe kjo vërehet nga debati i madh që ka filluar për hulumtimin shkencor, konferencat, ligjërimin, praktikën e me radhë. Se si do të duken universitetet e ardhshme, nuk dihet, por ajo që dihet është se ndryshime do të ketë. Askush nuk do ta shoh më me të njëjtin sy “studimin online” - perceptioni ka ndryshuar dhe duket se do të ndryshojë edhe më shumë. Se si do të ndikojnë ndryshimet që do të ndodhin, mbetet për t’u parë.

Në Departamentin e Antropologjisë, kemi vazhduar procesin e ligjëritit dhe ushtrimeve, si të gjithë në UP, përmes platformës digjitale *Google Meet*, pra online. Disa nga planet e Departamentit janë shtyrë për këtë vjeshtë, disa i kemi

realizuar, por pa dyshim se pandemia ka shkaktuar një ndërprerje të procesit të rrjedhshëm që kemi pasur në Departament. Një numër projektesh, ku kanë marrë pjesë stafi dhe studentët e Departamentit, janë ndërprerë dhe shtyer. Puna praktike e studentëve është ndërprerë, si në projekte hulumtuese ashtu edhe në institucione me të cilat kemi marrëveshje. Po ashtu edhe disa aktivitete, si Seminari i Antropologjisë, nuk janë mbajtur në muajt mars, prill dhe maj 2020, për arsye të pandemisë dhe masave preventive kundër lëvizjes.

Në anën tjetër, gjatë kësaj kohe, Departamenti ka nisur edhe punë specifike, siç është përgatitja e programit MA në “Antropologji të trashëgimisë kulturore”, për të cilin janë bërë disa hulumtime dhe propozime konkrete. Po ashtu, kolegë të Departamentit kanë shkruar dhe botuar studime të tyre në revista shkencore brenda e jashtë vendit, por edhe kanë përkthyer literaturë antropologjike, dhe kanë përpiluar projekte për të aplikuar në fonde të ndryshme hulumtuese. Studentët tanë po ashtu, kanë aplikuar në studimet postdiplomike dhe shumë prej tyre janë pranuar dhe vazhdojnë ato studime në Hungari, Britani të Madhe, Zvicër, Francë, Itali, Gjermani, etj. Disa studentë janë kthyer nga studimet e tyre semestrale në Slloveni e Britani, ku kanë fituar bursë si studentë të projekteve të ERASMUS + , por edhe projekteve ndërkombëtare të stafit të Departamentit të Antropologjisë.

Vjetari AA synon të përmbledh aktivitetin vjetor të Departamentit të

Antropologjisë, duke u fokusuar në punën e stafit dhe studentëve, por edhe në aktivitete të tjera që përkojnë me Departamentin e Antropologjisë. Edhe në këtë numër të dytë të vjetarit, do të gjeni një sërë informacionesh rreth aktiviteteve që kanë ndodhur në Departamentin e Antropologjisë, gjatë vitit akademik 2019-2020, përfshirë edhe shkrime të studentëve.

Siç do ta shihni edhe nga një shkrim i bazuar në hulumtime të studentëve, shumica prej tyre duan që t’i kthehemi normalitetit akademik dhe të mos ketë nevojë për zëvendësim virtual (online) të mësimin. Pavarësisht se çfarë mund të ndodh në të ardhmen, ne duhet të jemi të prirur nga parimi i “qëndresës”, siç thuhet në poezinë gurakuqiane në ballinë, dhe ta mposhtim edhe këtë barrierë, këtë test jo vetëm për universitetet, por për të gjitha shoqëritë.

Lexim të këndshëm!

Arsim Canolli
(udhëheqës i Departamentit të
Antropologjisë)

AA, Nr. 2, Shtator, 2020

Vjetar informativ i Departamentit të Antropologjisë, Fakulteti Filozofik, Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”

Redaksia: Arsim Canolli (kryeredaktor - arsim.canolli@uni-pr.edu); Arben Hajdari (redaktor - arben.hajdari@uni-pr.edu);

Tahir Latifi (redaktor dhe lektor - tahir.latifi@uni-pr.edu). Del njëherë në vit, në formë të shtypur dhe digjitale.

Uebfaqja: <http://filozofiku.uni-pr.edu/Departamentet/Departamenti09.aspx> (Ballina © Tringa Berbatovci, 2020)

INFO & AKTIVITETE

Gjatë vitit akademik 2019-2020, stafi dhe studentët e Departamentit të Antropologjisë kanë realizuar një numër aktivitete, si në projekte hulumtuese, ashtu edhe në konferenca shkencore, simpoziume dhe botime. Këtu do të jepen disa informacione rreth tyre.

Doracaku për studentë

Edhe këtë vit, Departamenti i Antropologjisë ofron “Doracakun e Antropologjisë”, një përmbledhje e përgjigjeve ndaj shumë pyetjeve që studentët potencialë dhe ata ekzistues i kanë rreth studimeve antropologjike dhe aktiviteteve edukative e kërkimore që realizohen nga Departamenti i Antropologjisë.

Për ta zbarkuar doracakun në formë digjitale, shkoni te vegza:

<http://filozofiku.uni-pr.edu/Departamentet/Departamenti09.aspx>

Mësimdhënësit e rinj në Departament

ILIR CULAJ

Në vitin akademik 2020-2021, Departamentit të Antropologjisë iu bashkua si staf i rregullt edhe asistenti Ilir Culaj (doktorant në histori antike/arkeologji), i cili do të mbajë ushtrimet në një numër lëndësh në programin e arkeologjisë. Studimet BA i ka përfunduar në “Universitetin e Prishtinës”, kurse ato të nivelit MA në Universitetin “Lumière-Lyon-II” të Francës. Aktualisht është duke ndjekur studimet doktorale në “École Normale Supérieure” (Paris) për arkeologji dhe histori të kohës antike. Fokusi i tij i studimeve përfshin periudhën romake, me theks të veçantë religjionin romak dhe epigrafinë latine.

ROZAFI BASHA

Këtë vit, Departamentit të Antropologjisë, si ligjëruese e angazhuar do t'i bashkëngjitet edhe kolegja Dr. Rozafa Basha, asistente në Fakultetin e Arkitekturës/UP. Ass. Dr. Sc. Rozafa Basha është asistente dhe ligjëruese e autorizuar në lëndët që mbulojnë fushën e projektimit të ndërtesave banesore në Fakultetin e Arkitekturës prej vitit 2003. Në vitin 2002 përfundoi studimet pesëvjeçare dhe mori titullin Inxhinierë e Diplomuar e Arkitekturës në Seksionin e Arkitekturës në Fakultetin e Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës në Prishtinë. Në vitin 2010 përfundoi studimet pasdiplomike në Universitetin e Lundit në Suedi dhe mori titullin Master Shkencor në Dizajnin Urban të Qendrueshëm. Në vitin 2019 mori titullin Doktor në Fakultetin e Arkitekturës dhe Urbanistikës në Universitetin Politeknik të Tiranës. Interesimet e saj studimore lidhen me fushën e projektimit të banimit, mjedisit të ndërtuar pa barriera dhe projektimit/ planifikimit me pjesëmarrje.

Në Departamentin e Antropologjisë, Dr. Basha do të ofrojë lëndën “Kultura e ndërtimit dhe banimit”, lëndë zgjedhore në semestrin VI në programin “Antropologji kulturore”.

DEPARTAMENTI I ANTROPOLOGJISË

Doracak për studentë
2020-2021



Departamenti i Antropologjisë, pandemia dhe Facebook-u

Ass. MA. Durim Abdullahu

Popullimi masiv dhe frekuentimi i dendur i rrjetit social Facebook në Kosovë, e ka prodhuar një kulturë masash unike të banimit të kësaj platforme interneti. Me aq shumë mundësi përdorimi që ka Facebook-u, në të cilin mund të hedhësh fotografi, video, albume, statuse, tekste, apo të ndërkomunikosh me chat bisedash individual a grupor, pëlqime, shpërndarje, evente, faqe, komunitete të profilizuara dhe qindra opsione ndërveprimi, ky rrjet social është shndërruar në një botë publike paralele, të banuar statistikisht nga gjysma e banorëve në Kosovë. Me këto përmasa përdorimi, Facebook-u në Kosovë shihet si një rrjet ku mund të komunikosh për shumëçka, por mbase jo plotësisht për gjithçka. Jetë universitare në Facebook?! Një lloj skololatrie që karakterizon përceptimet për jetën shkollare dhe veçanërisht atë të universitetit në Kosovë, krijon një rezistencë për ta parë Facebook-un si një fushë të përdorshme për studime.

Prej kohësh kishte një faqe dhe një grup të mbyllur në Facebook, për studentët e antropologjisë së Universitetit të Prishtinës, por të hapur dhe për të tjerë jashtë kësaj kategorie studentësh. Faqja “Kandi i Antropologjisë” që bërë faqe me postime të përgjithshme nga antropologjia, ndërsa faqja “Departamenti i Antropologjisë / UP” me postime të dedikuara kryesisht për studentët e antropologjisë së Universitetit të Prishtinës. Mbyllja e imponuar nga shpërthimi i pandemisë së virusit korona COVID 19, krijoi një gjendje izolimi dhe prerje të jetës publike, të zgjatur në shtrirje të paparashikueshme. Nga këtej, erdhi nevoja për të gjetur një mënyrë alternative për të vazhduar funksionimin e jetës shkollare. Universiteti i Prishtinës zgjodhi platformën e internetit “Google Meet” si më të përshtatshmen për të bartur

leksionet në formën online. Mijëra studentëve u hapën emaile zyrtare me emra të përveçëm të pasuar nga prapashtesa @student-uni.pr.edu. Kështu pas muajit të parë të kaluar në fakultet, semestri veror i vitit 2020, u zhvillua me ligjërata dhe ushtrime online.

Në këtë pikë, grupi i mbyllur “Departamenti i Antropologjisë / UP” do të hynte shumë në punë për komunikim dhe shpërndarje materialesh. Më 16 mars 2020, katër ditë pas mbylljes nga pandemia, si sekretar departamenti që kisha trashëguar administrimin e këtij grupi në Facebook, kisha postuar një njoftim drejtuar studentëve, në një situatë ku askush nuk e dinte se si do shkonin studimet online:

Të nderuar studentë,

Shpresoj që jeni mirë!

Kështu, me lëvizje të kufizuar siç jemi, do të bëjmë përpjekje të mos shkëputemi nga leksionet. Vetëizolimi që jemi shtërnguar të bëjmë, përreth rrethanshmërive të këtyre kohëve, natyrshëm na bën të reflektojmë për natyrën e njeriut dhe pozitën e tij në univers, çështje këto mbi të cilat është themeluar dhe vetë antropologjia filozofike, si një nga më të hershmet degë të antropologjisë. Meqë Universiteti i Prishtinës ka vendosur të vazhdojnë studimet online, teksa do të vëmë kontakt së bashku në platformat e përshtatura për këtë, do të përngjasojmë frikshëm me personazhet e Giovanni Boccacios te “Dekameroni”. Aty, në Firencën e vitit 1348, dhjetë të rinj, shtatë vajza dhe tre djem, për të shpëtuar nga murtaja e rënë në qytet, zhvendosen në rrethinë, duke u organizuar mes tyre përveç punëve të përdit-

shme edhe për të biseduar në një lëndinë për temën e ditës, lirshëm, pa frikën e murtajës. Google Meet do të jetë ‘lëndina’ jonë, ku për Murtajën Bubonike që vrau 2/3 e popullsisë në Europën e shekullit XIV, do të diskutojmë te lënda “Histori mesjetare e Europës”. Ndërkaq, që nesër në ora 11:00, do të mundohemi të bashkëlidhemi për ushtrimet e lëndës “Antropologji e religjioneve”, ku sipas radhës, do ta diskutojmë kapitullin “Seksi, gjinia dhe e shenjta”, ndër të tjera, për të parë pikëprerjet mes determinizmit biologjik dhe ndërtimit kulturor. Shpresoj të mos kemi probleme me teknologjinë! Na shkoftë mbarë! Kujdes dhe durim! Paçi shëndet!

*Nga karantina shtëpiake:
Durim Abdullahu*

Përgjatë muajve mars, prill dhe maj, profesorët e Departamentit të Antropologjisë do të hedhnin në këtë grup në Facebook, dhjetëra materiale të ndryshme për t’u qasur studentët në to. Libra online, biblioteka dixhitale, revista, dokumentarë, filma etnografikë, video-ligjërata, vegza për të vizituar online muze dhe të tjera materiale fakultative apo të sugjeruara nga profesorët për studentët e antropologjisë dhe arkeologjisë. Me një përshtatje dhe efikasitet vështirë të gjykueshëm, forma online e studimeve dhe komunikimeve në periudhën e mbylljes në izolim gjatë pandemisë, na vendos përpara nevojën për t’i menduar seriozisht platformat e internetit, për t’u banuar me jetë universitare!

[<https://www.facebook.com/groups/1815958132008905>]

Promovim i Monografisë “BOOM 1980-at”; Projekti ACT (*Changing the Story*)

Përgatiti: Prof. Ass. Dr. Nita Luci

Më datën 9 mars 2020 u mbajt promovimi publik i monografisë “BOOM 1980-at”, ku paraqitet materiali kërkimor dhe artistik i projektit “Zine BOOM”, i përkrahur nga projekti *Changing the Story* – ACT Kosovë (Departamenti i Antropologjisë në UP dhe Universiteti i Lidsit, Mbretëri e Bashkur). Monografia përmbanë material origjinal dhe arkivor mbi aktivitetet kulturore, shoqërore, mediatike dhe politike të koncerteve BOOM të muzikës rok në Kosovë gjatë viteve 1980-ta (hulumtimi dhe tekstet nga Rina Krasniqi dhe Lura Limani, dizajni nga Bardhi Haliti).

Rina Krasniqi shkruan:

“Ndonëse i harruar, BOOM-i, një festë e përvitshme që u mbajt prej vitit 1982 deri në vitin 1987, ishte festivali më i madh i rock muzikës në Kosovë. Për një kohë të shkurtë, BOOM-i u bë platformë për të rinjtë e Kosovës për të shprehur kreativitetin e tyre artistik e identitetin e tyre rinor; hapësirë për t’u takuar me artistë nga pjesët e tjera të Jugosllavisë dhe për të artikuluar një imazh të ri të kosovarëve. Me këtë sfond të komplikuar, rinia e Kosovës po mundohej të gjente një fjalor dhe zë për të definuar veten, për të krijuar një kulturë unikalisht të tyre dhe, në një masë të madhe dhe për një kohë të shkurtër arriti të bënte këtë përmes muzikës rock dhe pop. BOOM-i ishte mishërim i kësaj tentative.” (2020: 81-82)

Reflektimet e studentëve të Departamentit të Antropologjisë, të përmbledhuara gjatë punës në lëndën *Antropologji e Kujtesës dhe Krijimtarisë*, i kumtojnë disa nga perspektivat e sotme për një të kaluar të cilën monografia e gjurmon:

“Në një të kaluar të shpejtë në faqet e para të kopertinës - me shkronja të mëdha “BOOM,” në një poster, tfillohet qartë ideja e një shpërthimi kulturor. Posterat tjerë si ai me një zemër të lidhur me yllin socialist, parrullat “Frontalisht kundër Nacionalizmit”, “Festival”, “rock rropatje”, – e pyetje si “Bota u nis të silllet apo jo?”, që përfundojnë me një fotografi bardhë e zi të Prishtinës, ndërtojnë edhe më tej parashikimet mbi tekstin që zhvillohet si dialog mbi një narrativë të caktuar të të kaluarës e mbamendjes historike, që ndërtohet në kohët e sotme.” (Shpat Shkodra)

“Pos informacioneve për muzikën e kësaj kohe, libri poashtu na pasuron me njohuri mbi rrethanat politike e historike të asaj kohe. Kështu pershembull përmendet zhvillimi shoqëror i cili kishte nis në vitet 70’ta qysh me themelimin e Universitetit të Prishtinës, më pas edhe njohja e Kosovës si krahinë autonome (1974).” (Diora Arifi)

“Festivali BOOM erdhi si ilaç për rininë e Kosovës së asaj kohe... [mirëpo] gati se të gjitha grupet muzikore rok e të zhanreve të tjera ishin të krijuara nga burrat e, të pakta ishin gratë ato të cilat kishin krijuar bende në atë kohë.” (Arditë Aliu)



“Shoqëria e ditëve të sotme ka pasur nevojë që të dijë për kulturën që të rinjtë e vendit, por jo vetëm, kanë pasur për muzikën rok. Ne edhe në ditët e sotme i dëgjojmë disa nga këngët e atyre grupeve. Disa këngë që unë kam ndëgjuar kanë qenë të grupit të Fisnikëve dhe Gjurmëve. Dhe pse kanë kaluar shumë vite këngët e tyre ende ndëgjohej, si hite të pavdekshme. Kur njeriu fillon të shoh kulturën e mëhershme përmes artit dhe muzikës unë mendoj se do të gjejë shumë gjera më vlerë dhe do të shohë se sa shumë gjëra kanë ndryshuar.” (Era Draga)

“Libri shpërfaq një argument kryesor dhe ajo është vënia në pah e elitës së kohës. Elitë që u mundonte të përballej me idetë propagandiste të Jugosllavisë. Ide që i portretizonte shqiptarët e Kosovës si të prapambetur dhe të egër. Pra, për ta shembur këtë epitet klasat muzikore tentojnë të krijojnë një kulturë unike të tyre. Kulturë kjo që do të ishte e pathyeshme dhe me më pak mundësi të njollosej me epitete nga regjimi i kohës. Apo thënë ndryshe, rezistenca ndaj këtij pushteti bëhej përmes mesazheve të muzikës rock e pop. Sepse muzika konsiderohet të jetë gjuha e dashurisë, urtësisë dhe e paqes!” (Valentina Krasniqi)

“Pas disa intervistave që ishin bërë, intervistuesit kishin theksuar se kishte raste kur këngët të cilat inçizoheshin u ndryshojë teksti në mënyrë që të mos dukeshin politike dhe, disa nga grupet kishin mbetur pa i incizuar këngët pasi që kishin disa konflikte me producentët. Kishte raste kur ndonjëri nga anëtarët e grupeve duhej që të mos merrte pjesë në festivalin BOOM pasi që ishin në shërbim ushtarak.” (Elza Krasniqi)

“Në vendin tonë lindi një subkulturë që u shfaq në një kohë politikisht të trazuar dhe i frymëzoi të rinjtë të mendojnë lirshëm dhe të zbulojnë identitetin e tyre rinor, të jenë të lirshëm t’i shfaqin talentet e tyre për muzikën.” (Lorena Kozhani)



BANKROTT (BANKRUPT)

Në WC jemi ne (We are in the toilet) 1985

“20 intervistat formale dhe shumë të tilla joformale, si dhe kërkimi në shtypin mes viteve 1981-90 në arkivin e Bibliotekës Kombëtare, revistat Bota e Re, Kosovarja, Zëri i Rinisë, Novi Svet... ishin hulumtime dhe përpjekje që bënë punimet e tyre më të përpikta, po edhe interesante për t’i lexuar. Fotografitë marrin një pjesë të konsiderueshme, të cilat, sipas meje, janë të domosdoshme. Në to shohim të paraqitur pjesë të ndryshme të kryeqytetit, hapësirat publike e ‘studio’ ku performonin bendet e kohës. Posaqërisht vërejmë trendet e pamjes fizike si veshjet ose flokët më të gjata, të cilat në krahasim me kohën e sotme duket se kanë pësuar ndryshime të mëdha.”

(Diona Arifi)

“Historia e rokut në Kosovë fillimisht nis në qytetin e Prizrenit dhe Mitrovicës, duke vazhduar kështu, sa që deri në fund të viteve të 1960-ta të formoheshin disa bende, e më vonë edhe në qytetin e Ferizajit. Rol të rëndësishëm në popullaritetin dhe masivizimin e këtyre bendeve dhe bendeve të reja të muzikës rok dhe pop kanë luajtur Programi i dytë i Radio Prishtinës, Radio Televizioni i Prishtinës, revistat e ndryshme si Bota e re, Novi Svet, Zëri i Rinisë, e që vazhdon gradualisht më tutje edhe me krijimin e platformave të performimit të këtyre bendeve, pra hapësirave

publike e sociale, e deri të hapja e pallatit Boro dhe Ramizi si një sallë që do të mund të mblidhte deri në 10,000 njerëz.”

(Petrit Jusufi)

Studentët e Departamentit të Antropologjisë morën pjesë në punëtorinë tre-ditore (pril 2019) – bashkëpunim i Anibar Academy, Bournemouth University dhe Universiteti i Prishtinës – ku bashkëprodhuan tekste, muzikë dhe animacion, bazuar në materialin kërkimor të Zine BOOM.

Për më shumë shih:

<https://changingthestory.leeds.ac.uk/resources/cts-publications/act-critical-review/>
dhe

<https://changingthestory.leeds.ac.uk/resources/films/>

Bashkëpunimi midis Francës dhe Kosovës në fushën e studimeve arkeologjike 2017-2020

(Përgatiti: Prof. Ass. Dr. Arben Hajdari)

Bashkëpunimi midis Kosovës dhe Francës, respektivisht Universitetit të Prishtinës, Institutit Arkeologjik dhe Ecole Normal Superior në fushën e studimeve arkeologjike, i iniciuar në vitin 2017, ishte hapi i parë i një projekti gjithëpërfshirës, të qëndrueshëm e ndërdisiplinor, i cili ka dhënë rezultate të rëndësishme, si në fushën e hulumtimeve arkeologjike, po ashtu edhe në ngritjen e kapaciteteve profesionale.

Midis viteve 2017-2020, ekipi franko-kosovar, në drejtimin e arkeologëve Arben Hajdari (UP), Christophe J. Goddard (ENS) dhe Milot Berisha (IA) kanë përqendruar aktivitetet arkeologjike në zonën e bazilikës në Ulpianë, e ndërtuar mbi portikun e një tempulli të braktisur, me qëllim të dhënies përgjigje të shumë pyetje të rëndësishme të mbetura pezull. Falë një ekipi gjithëpërfshirës, përfshirë ekspertët më të mirë në fushën e arkeologjisë, të qeramikës, gjeologjisë, arkeobotanikës, epigrafisë, numizmatikës, analizave kimike, studimit dixhital etj. është arritur të përcaktohen fazat suksesive të ndërtimeve dhe transformimeve që ka njohur qyteti në zonën e bazilikës ndër shekuj, duke vënë në pah edhe shkaqet që përcaktuan këto transformime. Në anën tjetër, falë këtij programi katër-vjeçar, është arritur po ashtu të propozohet një klasifikim i ri tipologjik i qeramikës dhe qelqit, kontribut ky që do t'u mundësojë studiuesve të fushës në të ardhmen të datojnë më me saktësi gjetjet e ndryshme të periudhës romake, antikitetit të vonë dhe mesjetës, që do të zbulohen në qytetin e Ulpianës. Kontribut tjetër i rëndësishëm i këtij projekti është edhe realizimi i incizimeve gjeofizike, rezultatet e të cilave pasqyrojnë qartë transformimin e qytetit nga Ulpiana në Justiniana Secunda.

Pjesë e rëndësishme e këtij projekti është programi i shkëmbimit, komentorimi i përbashkët i studentëve në nivelin MA dhe PhD si dhe krijimi i shkollës arkeologjike në Ulpianë. Deri me tani nga ky program kanë përfituar gjashtë (6) studentë, të cilët si bursistë të qeverisë franceze kanë përfunduar dhe po ndjekin studimet në Francë pranë ENS-PSL (Paris), në fushën e arkeologjisë dhe disiplinave të saj, në nivelin BA dhe PhD. Kurse në kuadër të shkollës arkeologjike kanë gravituar studentë të shumtë vendorë dhe ndërkombëtarë, të cilët kanë pasur mundësi të njihen për së afërmi me metodat dhe teknikat bashkëkohore, që aplikohen sot në fushën e studimeve arkeologjike. Partner i rëndësishëm i këtij projekti, është Ambasada e Francës në Prishtinë, e cila deri me tani, ka



ndarë 4 bursa për studentët tanë në nivelin Master dhe 2 për ata në PhD.

Rezultatet e arritura pëgjatë viteve 2017-2020 në fushën e hulumtimeve dhe ngritjes së kapaciteteve, kanë qenë parakusht i kryesor që projekti i përbashkët franko-kosovar në Ulpianë të fitojë një fond në vlerë prej një milion euro nga Bashkimi Evropian, për të vazhduar misionin e hulumtimeve interdisiplinare në qytetin e Ulpianës dhe zgjeruar Parkun Arkeologjik të Ulpianës gjatë viteve 2020-2023.

Ekipi drejtues në krye me arkeologët Hajdari, Goddard dhe Berisha, pos hulumtimeve arkeologjike, në kuadër të këtij programi, vëmendje të veçantë parashihet t'i kushtojnë hartimit të një programi evropian të nivelit MA në arkeologji klasike midis Francës, Kosovës dhe Italisë, ku studentët do të ndjekin të njëjtën kurrikulë në tre vendet e ndryshme. Kësisoj, Franca, Italia dhe Kosova do të jenë në gjendje t'u ofrojnë atyre fushat e tyre më të mira të ekspertizës. Gjithashtu, vëmendje e shtuar do t'i kushtohet shkollës arkeologjike e cila synohet të zgjerohet dhe pres studentë vendor dhe ndërkombëtarë të cilët pas përfundimit të shkollës do të mund të pajisen edhe me certifikatë dhe ECTS kredite të vlefshme në të gjitha universitetet evropiane.

Perspektiva studimore mbi Kosovën

(Simpozium, konferencë dhe ekspozita)

(Përgatiti: Prof. Ass. Dr. Arsim Canolli)


Në kuadër të bashkëpunimit të vazhdueshëm mes Departamentit të Antropologjisë (Fakulteti Filozofik/UP) dhe Institutit të Antropologjisë Kulturore dhe Studimeve të Artit (IAKSA/Akademia e Studimeve Albanologjike) në Tiranë, më 20 dhe 21 dhjetor 2019 u mbajt simpoziumi “*Perspektiva studimore mbi Kosovën*”. Ky simpozium u organizua për hirë të 20 vjetorit të çlirimit të Kosovës dhe pati një konferencë dhe dy ekspozita.

IAKSA organizoi po ashtu edhe një ekspozitë fotografike të quajtur “*Kosova nÿ e n’dorë të etnografit*”, kuruar nga antropologu Dr. Olsi Lelaj, ku u paraqitën foto-grafitë e ekspeditës studimore të disa studi-uesve, etnografë e folkloristë të Institutit të Kulturës Popullore (ish-IAKSA) dhe Institutit Albanologjik të Prishtinës, në korrik të vitit 1999, që kishte pasur temë refugjatët kosovarë të vendosur në kampet e pritjes në Durrës, Kukës dhe Tiranë. Po ashtu, në ambientet e IAKSA u shfaq edhe ekspozita etnografike “*Dëshmi të kulturës materiale të Kosovës*” me artefakte nga Ko-sova nga fondi i pasur i IAKSA-s, kuruar nga etnografja, Prof. Dr. Afërdita Onuzi.

Konferenca mbledhi studiues nga Kosova e Shqipëria, antropologë të kulturës, arkeologë, historianë e sociologë, për të diskutuar mbi perspektivat studimore mbi Kosovën, shoqërinë dhe kulturën e saj. Në konferencë prezantuan: Prof. Ass. Dr. Arben Hajdari (*Transformimi i vendbanimeve në Dardani gjatë antikitetit të vonë-mesjetës së hershme përballë kërcënimit barbar*), Prof. Ass. Dr. Arsim Canolli (*Prej bukës të shteti: antropologji e Kosovës*), MA. Ass. Zanita Halimi (*Fotografia familjare si refleks i konteksteve shoqërore*), MA. Ass. Durim Abdullahu (*Lusta e Kosovës: rrëfyer*

nga gazetarët), Dr. Lumnije Kadriu (Familja trans-tradicionale si rrjedhohë e trendeve trans-nacionale), Prof. Ass. Dr. Shemsi Krasniqi (Ndjesia për natyrën, trashëgimia dhe kujtesa për luftën në Kosovë), Dr. Linda Gusia (Kujtesa e shtëpive-shkolla në Kosovë, rimediatizimi dhe digjitalizimi), Prof. Asoc. Dr. Nebi Bardhoshi (Antropologjia, kufiri, prona), Dr. Olsi Lelaj (T'parit nëpërmjet Kosovës).

Punimet e kumtuara në konferencë botohen në përmbledhjen e përgatitur nga redaktorët Nebi Bardhoshi & Arsim Canolli me titull “*Kosova antropologjike*” (2020).



SEMINARI

Përgatiti: Prof. Ass. Dr. Arsim Canolli

Seminari i Antropologjisë synon avancimin e mendimit të lirë dhe diskutimit kritik antropologjik përmes ligjëratave, tryezave dhe aktiviteteve tjera shkencore e profesionale. Qëllimi kryesor i këtij Seminari është të organizojë ligjërata mysafire me studiues të antropologjisë kulturore, arkeologjisë, historisë dhe shkencave tjera shoqërore e dijeve humane dhe të hapë mundësi për dialog, diskutim e njohje mes studiuesve të këtyre fushave. Seminari i Antropologjisë udhëhiqet nga stafi i Departamentit të Antropologjisë, përkatësisht nga profesorët Arben Hajdari dhe Arsim Canolli. Gjatë vitit akademik 2019/2020 janë planifikuar 8 ligjërata, por janë realizuar vetëm 5 sosh, për arsye të pamundësisë së shkaktuar nga pandemia COVID 19.



1. Misioni arkeologjik franko-shqiptar në Apolloni të Ilirisë



Më 31 tetor 2019, Profesor Jean Luc Lamboley mbajti ligjërata të tij mysafire mbi misionin franko-shqiptar në Apolloni, një nismë e Leon Rey-t në 1923 dhe rikthim pas diktaturës nga Pierre Cabanes dhe Jen Luc Lamboley, më 1993-94. Një mision 25 vjeçar i pandërprerë dhe një punë madhore hulumtuese atje.

Prof. Lamboley prezantoi peshën e Apollonisë si polis, pastaj edhe gjetjet arkeologjike dhe arkitekturën urbane të saj. Ai theksoi edhe vazhdimin e punës

nga arkeologët shqiptarë sidomos në numizmatikë.

Ai foli edhe për përvijën e tij si arkeolog në Shqipërinë e viteve '90 dhe pastaj edhe për bashkëpunimin me profesorin Edi Shukriu nga Universiteti i Prishtinës, prej vitit 2006. Folë edhe për bashkëpunimin që Ecole Normal Supérieure ka me Departamentin e Antropologjisë në UP dhe Institutin Arkeologjik të Kosovës, në Ulpianë.

Një ndër fjalët kyçe të ligjërata të profesor Lamboley-së ishte fjala "besim".

Arkeologët duhet të punojnë në mirëbesim me njëri tjetrin, sidomos në projekte ndërkombëtare, edhe si profesionistë edhe si njerëz, sepse arkeologjia është një punë grupore.

Pas ligjërata, pati një diskutim të ngjeshur me studentët dhe kolegët. Pastaj, diskutimi vazhdoi edhe në koktejin e organizuar nga Departamenti.

2. Trashëgimia atrociare



Në kuadër të Seminarit të Antropologjisë 2019-2020, më 21 nëntor 2019, ligjëroi Nora Visoka-Weller, doktorante në Departamentin e Arkeologjisë dhe Antropologjisë në Universitetin e Cambridge-it.

Tema e saj ishte “Trashëgimia atrociare: një qasje e re mbi studimin e të pagjeturve në Kosovë gjatë luftës 1998-1999”. Nora hapi skenën e studimit të saj duke folur për konceptet, qasjet dhe teoritë kryesore në interpretimin e trashëgimisë kulturore, gjithnjë nga pikëpamjet antropologjike. Pastaj ajo diskutoi për konceptin e “trashëgimisë atrociare” në kuadër të diskutimit mbi trashëgiminë e errët apo trashëgiminë tabu, të cilat kanë hapur një shteg të ri të studimeve mbi trashëgiminë kulturore, fillimisht në studimet mbi turizmin e errët e pastaj edhe në kontekst të gjerë të trashëgimisë, përkatësisë, kujtesës e me radhë.

Ligjërata vuri në theks kryesor monumentalizimin e trashëgimisë atrociare, respektivisht ruajtjen e asaj trashëgimie si kujtesë për ngjarjet, njerëzit, kohën dhe vendin ku ka ndodhur lufta apo masakra. U krahasuan vende të ndryshme, si Ruanda, Bosnia, Gjermania,

Franca, në të cilat janë memorializuar e monumentalizuar vendet e atrociare dhe shumica janë ruajtur/konservuar ashtu si janë. Pastaj, Nora foli për masakrat dhe varret masive në Kosovë, të shkaktuara gjatë luftës së viteve 1998-1999, dhe mënyrat e memorializimit të tyre në Kosovë, por foli edhe për tentativat e shoqërisë civile në Serbi.

Studimi i saj, i realizuar përmes intervistave dhe diskutimeve me akterë të ndryshëm të shoqërisë civile, akademisë dhe institucioneve shtetërore, të mbijetuarve të familjeve të masakruarve, nxorri në pah gjendjen e tanishme memorializuese e kujtesore. U tha se në Kosovë ekziston një uniformitet i memorializimit të trashëgimisë atrociare, përderisa ka edhe raste specifike, kur familjarët krijojnë modelet e tyre të trashëgimizimit të shtëpisë së tyre, apo gjësendeve të tyre, si është ai i zonjës Ferdonije Querkezi e cila e ka shndërruar shtëpinë e saj në muze. Ndërsa, në Serbi, ka pasur edhe raste nga disa akterë të shoqërisë civile që të shenjojnë varrezat massive, si në rastin e Batajnicës. Megjithatë, në ligjëratë, por edhe gjatë diskutimeve, u theksua se trashëgimia

atrociare ka qenë dhe ende mbetet temë tejet e politizuar, për arsye të ndryshme.

Po ashtu, u theksua edhe nevoja psikologjike e shoqërisë kosovare për të kujtuar duke trashëgimizuar, por u theksuan edhe rastet tjera në botë, ku varret, vendet e masakrës, varrezat masive, kujtesa mbi luftën janë pjesë e trashëgimizimit kolektiv në ato shoqëri.

Ligjërata hapi një sërë hullish të diskutimit dhe interpretimit të trashëgimisë atrociare, të monumentalizimit të varreve, të menaxhimit të memorialeve, të dokumentimit të kujtesës mbi luftën, të rolit të shtetit, por edhe familjeve, në vlerësimin dhe menaxhimin e kësaj trashëgimie, për të kujtuar atë që ka ndodhur në luftën e fundit në Kosovë.

Prof. Arsim Canolli falënderoi znj. Visoka-Weller, e cila erdhi enkas nga Cambridge-i i Mbretërisë së Bashkuar për ligjëratë, dhe pjesëmarrësit e shumë të erdhën për të dëgjuar, pyetur e diskutuar.

Diskutimi vazhdoi gjatë koktejit të organizuar nga Departamenti.

3. “Le të diskutojmë për ndryshimet klimatike nga pikëpamja e shkencave shoqërore”

Më 12 dhjetor 2019, Dr. François Lerin, si të krijojmë platforma të qëndrueshme studiues i shkencave shoqërore, i specializuar në shkencat ekonomike dhe anëtar i AIDA (Association Internationale pour le Développement de l'Agroenvironnement / International Association for Agroenvironment Mainstreaming), mbajti një ligjëratë mbi metodat, konceptet, teoritë dhe qasjet e shkencave shoqërore mbi ndryshimet klimatike. Sipas tij, shkencat shoqërore japin një kontribut të rëndësishëm në studimin e ndryshimeve klimatike, që shpesh nuk vërehet nga studiuesit e shkencave natyrore. Ai foli për ambientalizmin nga perspektiva e sociologjisë dhe politikave publike, por edhe nga ajo e etnografisë dhe sociologjisë.

Pa evidencën e efektit të ndryshimeve klimatike mbi popullsitë e ndryshme, nuk mund të dijmë shumë për mënyrat se

si të krijojmë platforma të qëndrueshme kundër këtyre efekteve që mund të jenë edhe imediate edhe afatgjate.

Dr. Lerin foli për ekonominë politike të “zero-karbonit”, për kombinimin e qëllimeve ambientale dhe sociale, për impaktin e teknologjisë në reduktimin e karbonit, për financat e qëndrueshme dhe investimet shtetërore dhe globale, e shumë tema të tjera të përafërta.

Diskutimi vazhdoi gjatë koktejit të organizaur nga Departamenti.



4. RAPID-K - Arkeologji e Kosovës parahistorike

Më 16 janar 2020, profesori i antropologjisë dhe arkeologjisë në Universitetin e Michigan-it, Dr. Michael Galaty, mbajti ligjëratën e katërt të Seminarit të Antropologjisë. Ai foli për punën 2 vjeçare në kuadër të projektit RAPID-K, sërvejim arkeologjik në rrethin e Pejës dhe Istogut, si vazhdim të kërkimit arkeologjik parahistorik në rajonin e Ballkanit.

Dr. Galaty dha një panoramë të hulumtimeve të tij të mëhershme në Shqipëri, ku gjatë viteve 1998-2003 ka qenë bashkëdrejtues i Projektit Arkeologjik të Regjionit të Mallakastrës në Shqipëri, program i orientuar në sërvejim dhe gërmim në Apolloni. Ai, po ashtu, dha një përmbledhje të rezultateve të projektit interdisiplinar në luginën e Shalës në veri të Shqipërisë dhe projektit arkeologjik në rrethinë e qytetit të Shkodrës. Në pjesën

e dytë të ligjëratës, Dr. Galaty prezantoi projektin e bashkëdrejtuar me arkeologët, Sylvia Deskaj dhe Haxhi Mehmetaj, në kuadër të të cilit është realizuar një sërvejim i thellë dhe sistematik i zonës për të identifikuar evidenca arkeologjike, shtresat prej parahistorisë e këndeje. Ai tregoi se kanë gjetur shtresa dhe koncentime të jashtëzakonshme, duke filluar nga ato neolitike e deri te ato të shekujve të sundimit osman. Dr. Galaty shpjegoi se rezultatet e para janë shumë premtuese sepse ka evidenca të shumta. Projekti RAPID-K, në rrethin e Pejës e Istogut, do të vazhdojë edhe këtë vit. Në këtë projekt kanë marrë pjesë, për 2 vite me radhë, edhe 3 studentë të arkeologjisë (Fatbardha Hoxha, Kaltrina Igrishita dhe Lekë Shala) nga Departamenti i Antropologjisë/UP.

Gjatë diskutimit me kolegë e stu-

dentë, Dr. Galaty foli edhe për nevojën e bashkëpunimit të arkeologëve të Kosovës me kolegët e tyre ndërkombëtarë dhe anasjelltas. Sipas tij, puna në grup mes arkeologëve që përdorin metoda të ndryshme dhe vijnë nga shkolla të ndryshme të trajnimit, është vetëm frytdhënëse dhe sjell rezultate më të mira shkencore. Sipas tij, kjo është e ardhmja e arkeologjisë, sepse pa kohezion grupor rreth qëllimeve të hulumtimit objektiv të së kaluarës, me metoda e teknika bashkëkohore të hulumtimit, nuk ka rezultate shkencore dhe të qëndrueshme në arkeologji. Në diskutimin e shumë tezave e rezultateve, dolën në pah dy gjëra kryesore që duhet mbajtur mend. Së pari, ai theksoi se Kosova është tejet e pasur me evidencë nga parahistoria, dhe, së dyti, ai theksoi se arkeologjia është shkencë e dije e shtresu-

ar dhe e ndërlidhur me shkencat e tjera.

Nga diskutimi i rezultateve fillestare, Dr. Galaty nxori në pah se projekti RAPID-K, një bashkëpunim mes arkeologjisë amerikane dhe kosovare, synon të kontribuojë në avancimin e studimeve mbi parahistorinë e Kosovës. Ai theksoi se projekti ka edhe ueb-faqen, ku gjendet informacioni i përgjithshëm mbi projektin dhe mund të lexohen rezultatet e para të sërveimit në Pejë e Istog.

Diskutimi vazhdoi gjatë koktejit të organizuar nga Departamenti.



<https://sites.lsa.umich.edu/kosovo-archaeology/>

5. Prej gjuhësisë te antropologjia linguistike



Më 27 shkurt 2020, u mbajt ligjërata e pestë mysafire në kuadër të Seminarit të Antropologjisë 2019-2020, ku Profesor Daniel Petit (Ecole Normale Supérieure dhe Ecole Pratique des Hautes Etudes, Paris) prezantoi një pamje të tri tipeve kryesore të krahasimit linguistik. Ligjërata pati temë krahasimin tipologjik, gjenealogjik dhe gjeografik, duke u fokusuar në përparësitë e sfidat e secilit krahasim,

duke marrë shembuj konkret nga gjuhë të ndryshme. Si indoeuropianist, profesor Petit, analizoi shembuj kryesisht nga gjuhët indoeuropiane, ku analizoi në kontekst të krahasimit edhe raste nga gjuha shqipe. Para studentëve dhe kolegëve të Departamentit të Antropologjisë dhe kolegëve të departamenteve të tjera në kuadër të Fakultetit Filozofik, por edhe ko-

legëve nga Fakulteti i Filologjisë, profesor Petit theksoi rëndësinë e gjuhës shqipe në kontekst të krahasimit linguistik, duke potencuar aspekte specifike të saj. Për shembull, ai foli për mënyrën habitore, si rast unik në gjuhët indoeuropiane, por edhe në gjuhët e tjera botërore. Pas ligjërates, pati pyetje e diskutime të frytshme, sidomos për qasjen antropologjike të studimit të gjuhës, raportin e gjuhës me kulturën, partikularitetin historik të gjuhës dhe difuzionin me gjuhët tjera, studimin e gjuhës totalitare, gjuhës diasporike, gjuhës mediatike etj. U theksua nevoja për ngritjen dhe avancimin e studimeve specifike antropologjike apo “antropologjisë linguistike” si nëndisiplinë antropologjike që studion raportin e gjuhës me kulturën dhe jetën shoqërore të gjuhës.

Diskutimi vazhdoi gjatë koktejit të organizuar nga Departamenti.

Për arsye të shpërthimit të pandemisë COVID - 19 dhe masave të shpallura nga institucionet shtetërore, aktivitetet mësimore u ndalën edhe në Universitetin e Prishtinës. Për këtë arsye, nuk u mbajtën tri ligjëratat mysafire të planifikuara për mars, prill dhe maj 2020. Ato ishin:

26 mars 2020 - Dr. Paula Callus, Head of Research, NCCA (National Centre for Computer Animation), Faculty of Media and Communication, Bournemouth University, UK

“Reanimating Contested Spaces (ReSpace): Designing Participatory Civic Education for and with Young People in Kosovo and Rwanda”

30 prill 2020 - Dr. Mikaela Minga, hulumtuuese shkencore dhe udhëheqëse e Departamenti të Folklorit/ Instituti i Antropologjisë Kulturore dhe Studimit të Artit/ASA/Tiranë

“Tinguj dhe zëra qytetës: Elbasani në regjistrimet zanore të arkivit audiivizual të IAKSA-së”

28 maj 2020 - Dr. Andrea Pieroni, profesor of ethnobotany and ethnobiology/rector of Universiteta di Scienze Gastronomiche di Pollenzo/Italy

“The intersection between ethnobotany and anthropology: the case of Albania and Kosovo”

Departamenti i Antropologjisë falënderon kolegët që kanë shprehur dëshirën të jenë mysafirë të Seminarit. Shpresojmë se do t'i kemi mes nesh në seminarin e ardhshme.

TRYEZË E DEPARTAMENTIT TË ANTROPOLOGJISË (12 shkurt 2020)

Para fillimit të semestrit veror, Departamenti i Antropologjisë mbajti tryezën e brendshme me temë “Antropologjia dhe terminologjia: termat, konceptet dhe kuptimet e tyre”, ku profesorë të antropologjisë nga Departamenti i Antropologjisë dhe kolegë nga Departamenti i Historisë, Sociologjisë dhe Instituti Albanologjik prezantuan argumentet e tyre.

U fol për një mori konceptesh dhe kontekstin e tyre empirik dhe teorik, u diskutua për valencën e koncepteve në antropologji kulturore dhe arkeologji dhe u prezantuan një sërë projektesh të reja studimore që kolegët e Departamentit kanë nisur.

Organizatorja dhe moderatorja e tryezës, Zanita Halimi, asistente në Departamentin e Antropologjisë, theksoi se tryeza të tilla do të mbahen edhe në të ardhmen, por duke zgjeruar bashkëpunimin

imin e Departamentit me departamentet e tjera të Fakultetit Filozofik, por edhe me Fakultetet e institucionet tjera akademike brenda dhe jashtë vendit.

Ajo falënderoi të gjithë kolegët pjesëmarrës të Departamentit të Antropologjisë, kolegët nga Instituti Albanologjik, Fakulteti i Filologjisë, studentët tanë dhe të gjithë të tjerët që morën pjesë në tryezën e parë të brendshme të Departamentit.

Në faqet e ardhshme do të jepet një përmbledhje e abstrakteve/rezimeve të prezantimeve në tryezë.



ANTROPOLOGJIA & TERMINOLOGJIA

(Kumtesat)

1. Burime në lëvizje: energjia, gjinia dhe riprod-

Prof. Ass. Dr. Nita Luci

Një ndër përshkrimet dominuse në akademi por edhe në politikë dhe në media rreth kufijve ka të bëjë me lëvizjen - përkohëshmërinë, kufizimin, dhe rrugëtimin – e njerëzve. Së fundmi, kufijt dhe demarkacioni i tyre, ligjor, politik, dhe menaxhimi ushtarak i tyre, flet në thelb për praktikat gjithnjë e në rritje të menaxhimit, përmbledhjes dhe amplifikimit të këtyre lëvizjeve.

Sidoqoftë, në këto lëvizje të njerëzve dhe kufijëve ka gjithashtu lëvizje të sub-stancave, burimeve dhe infrastrukturave që trancedentojnë dhe njëherazi rikonfirmojnë përvijëzime të strukturave të tilla politike dhe administrative, nacionale dhe gjeografike. Energjia është një nga këto substanca - burim që gjithnjë e më shumë i shtyn njerëzit nga hapësirat dhe vendet e caktuara (shtëpitë, vendbanime, menyrat e jetesës) dhe i zhvendos ata në hapësirat e reja si dhe në pozita të caktura politike dhe socio-ekonomike (si imigrant mjedisor, aktivist, qytetar dhe konsumator).

Argumeti im është se energjia mund të na ofrojë një lidhje bindëse në një bashkërenditje të re të paradigmeve të kalura (p.sh shpartallimin e infrastrukture so-

cialiste në resurse të reja nacionale dhe private) dhe në ndërtimin e marrdhënjeve të reja me energjinë si pikënisje të aktivizmit mjedisor dhe qytetar në Evropën Juglindore.

Hulumtimi im analizon prodhimtarinë bujqësore të grave si vendndodhje për ta gjurmuar zhvendosjen e paradigmeve rreth regjimeve të energjisë në Kosovë. Lëvizshmëria dhe palëvizshmëria e resurseve, e mobilitetit shoqëror, si dhe komodifikimi dhe politizimi i tyre krijon kontekst në artikullimin e identiteteve të reja sociale. Duke u mbështetur në “imajjinime mjedisore”, nocion i huazuar nga Peet and Watts (1996,) propozoj të shohim “imajjinimet e grave” rreth energjisë dhe t’i lokalizojmë në pejzazhet e zhvendosjes së paradigmeve që e përcjellin regjimin e energjisë në Kosovë. Gjithashtu synoj të shqyrtoj mënyrat se si projektet e energjisë kanë transformuar rolet e grave në prodhimin dhe riprodhimin shoqëror, si dhe varësinë e tyre nga regjimet shtetërore-institucionale dhe globale të energjisë (Cielo, Coba and Vallejo 2016). Pohoj që kjo ndarje, e rëfëson ndarjen në sferën prodhuese dhe sferën riprodhuese,

ku subordinimi i riprodhimit shoqëror në prodhim për profit qëndron në thelb të prodhimit të marginalitetit dhe shfuqizimit (Federici 2005).

2. Ekokultura

Prof. Ass. Dr. Shemsi Krasniqi

Ky prezatim përmban shpjegimin e konceptit 'ekokulturë', koncept ky qëndror i tezës sime të doktoratës, si dhe titull po ashtu qëndror, i librit tim të botuar nga ASHAK në vitin 2016. Kjo ka të bëjë me elementet që ka krijuar kultura popullore shqiptare në raport me natyrën, elemente këto të cilat nuk janë vetëm vlera, koncepte dhe parime, por janë edhe sjellje dhe praktika të rëndësishme sociale. Me ekokulturë kuptojmë tërësinë e elementeve kulturore të krijuara në interaksion me natyrën, të krijuara nga ndërvarësia dhe tradita e gjatë e bashkëjetesës së njeriut me krijesat organike dhe inorganike të natyrës, me mjedisin jetësor, ekosistemin dhe faktorët ekologjikë, me florën, faunën dhe gjithë biodiversitetin. Ekokultura nuk është vetëm sistem i dijeve dhe botëkuptimeve mbi natyrën, por edhe sistem i vlerave morale dhe lidhjeve emocionale me të. Ajo është sistem i sjelljeve dhe veprimeve praktike, sikurse edhe i përfytyrimeve dhe akteve simbolike.

Pjesë e prezantimit është edhe metodologjia bukur komplekse që është përdorur për realizimin e projektit 'Ekokultura'. Pjesë e këtij kompleksiteti është edhe videografia, ku si derivacion i saj ka dalur projekti 'Arterren' – ekspozitë me fotografi të bëra prej vitit 2007 deri në vitin 2017 dhe të përmbledhura në katalogun me të njëjtin emër, të botuar nga MKRS dhe të përkthyer në anglisht, frengjisht, gjermanisht dhe italisht. Ideja kryesore e Arterren-it është se gjatë punës empirike në terren, është e mundshme por edhe

e nevojshme të bëhen fotografi artistike.

Prezantimi na bën me dije se studimet e deritashme në etnologjinë shqiptare nuk kanë qenë gjithaq të përqëndruara në mënyrën e përfytyrimit të natyrës. Disa festa dhe rituale që lidhen me ringjalljen e natyrës, si Shëngjergji dhe Verëzat, janë studiuar, por jo pelegrinazhet në male dhe ritet e kalimit në gurë, e të cilat janë mjaft domethënëse në kuptimin antropologjik, të lashta në kuptimin historik, por edhe bukur masovike në kuptimin sociologjik.

Pjesë e prezantimit janë edhe ato që i kemi quajtur koncepte të ekokulturës, e të cilat pasqyrojnë lidhjen shpirtërore të njeriut me natyrën, dhe që mund të konsiderohen premisa të një etike mjedisore në kulturën popullore shqiptare. Të tilla janë konceptet si: ahti, bekimi, betimi, metamorfoza, empatia, shembëllimi, shejtërimi etj. Këto elemente të trashëgimisë shpirtërore kanë patur një funksion në ruajtjen e baraspeshës ekologjike. Në terren zakonisht gjenden të lokalizuara dhe duken sikur janë të izoluara dhe partikulare, por në formë dhe përmbajtje, janë krejtësisht universale. Universale dhe globale është edhe simbioza e trashëgimisë kulturore me atë natyrore, sepse lidhja me natyrën është pjesë e domosdoshme e kulturës njerëzore, sikurse që është kusht i domosdoshëm i ekzistencës njerëzore.



"Fërkemi" © Foto nga Shemsi Krasniqi

3. Perspektiva transnacionale në studimet bashkëkohore

Prof. Ass. Dr. Lumnije Kadriu

Në studimet transnacionale unë personalisht hasa kur fillova të merrem me praktikimin e pushimeve të diasporës, me theks në ruajtjen e lidhjeve të tyre me familjen dhe me vendlindjen.

Studimet transnacionale kanë të bëjnë me rrjedhat dhe këmbimet e ndryshme ekonomike, shoqërore e kulturore përtej kufijve dhe, pikërisht për këtë arsye këto janë të lidhura ngushtë edhe me studimet për diasporën.

Njëra ndër arsyet e kësaj qëndron fillimisht në faktin se studimet për diasporën janë çdo herë e më të shumta dhe së dyti, meqë vetë koncepti i diasporës është zgjeruar mjaft. Kështu, termi që fillimisht përshkruante shpërndarjen e hebrenjve, grekëve e armenëve, tash ka marrë, siç pohon autori Rogers Brubaker dhe pajtohen të tjerët, domethënie/kuptimet nga domeni më i gjerë semantik, i cili përfshin fjalët si imigrant, emigrant, refugjatë, punëtorë vizitorë, komunitet i shpërngulur, komunitet etnik.

Studimet transnacionale janë të lidhura ngushtë edhe me ato mbi globalizimin dhe që të dyja merren me studimin e koncepteve të ndryshme si ai i vendlindjes, komunitetit, kulturës, identitetit, shtetit nacional, përkatësisë, lokalitetit etj.

Diskursi mbi migrantët transnacional filloi gjatë viteve 1990-të. Nina Glick Schiler kishte vërejtur se 'transmigrantët janë ata migrantë jeta e përditshme e të cilëve varet nga ndërlidhjet e shumëfishta dhe konstante përgjatë kufijve ndër-kombëtarë dhe identitetet publike

të të cilëve janë të konfiguruar në raport me më shumë se një shtet-komb[...] kështu që ata gjithashtu [...]mbajnë, ndërtojnë dhe përforcojnë lidhje të shumëfishta me vendet e tyre të origjinës [...]', derisa 'migrimi transnacional është një proces me anë të të cilit migrantët krijojnë dhe ruajnë raporte shoqërore simultane dhe të shumëfishta që lidhin shoqëritë e tyre të origjinës dhe të vendosjes.'

Me zhvillimin e studimeve transnacionale u zhvilluan edhe shumë qasje dhe shumë koncepte të cilat bëjnë të mundur të kuptuarit sa më të plotë të këtyre kategorive shoqërore mobile. Të tilla janë psh. qasjet prej së larti (të cilat merren psh. me funksionimin e lidhjeve, rrjetave të mëdha ekonomike) apo prej së poshtmi (që vëzhgojnë lëvizjen dhe sjelljen e njerëzve të thjeshtë në përditshmërinë e tyre). Ndër konceptet tjera që lehtësojnë studimin transnacional është ai i hapësirave transnacionale (Thomas Faist) apo fushave transnacionale (Levitt & Schiler)

Studimet transnacionale shquhen për qasjen multidisiplinare në fenomenet që trajtojnë.



Foto e familjes Heqimi

4. Romanizimi/akulturimi - asimilim apo modë jetese

Prof. Ass. Dr. Arben Hajdari

Në kuadër të këtij prezantimi është trajtuar procesi i akulturimit/romanizimit, që nga përdorimi i tij si nocion në shërbim të matjes së tërësisë së ndryshimeve politike, socio-kulturore dhe ekonomike, në të cilat u përfshinë territoret e pushtuara nga romakët.

Debatet mbi romanizimin/akulturimin, që nga paraqitja e tij si nocion në shekullin e XIX-të, kanë qenë të ndikuara dukshëm nga konceptet dhe ideologjitë, ku secila gjeneratë e historianëve e përdorte atë sipas kornizave dhe botkuptimeve të periudhave në të cilat ata jetonin, si bie fjala të perandorive të kolonive evropiane, të dekolonializmit, integritit evropian, globalizimit ekonomik, perëndizimit kulturor etj. Kësisoj, nocionet si kolonizim, imperializëm, kolonializëm, pazhvillim, qendër dhe periferi, asimilim, rezistencë, integrim, ndërmjetësim etj. shërbyen për të komentuar praninë apo mungesën e elementeve të konsideruara romake brenda një shoqërie indigjene.

Me kalimin e kohës, romanizimi/akulturimi është bërë një gjuhë e përbashkët e historianëve për të narrativizuar historinë e Perandorisë Romake, apo thënë ndryshe për të përshkruar shumësinë e shndërrimeve që ndodhën në territoret e provincave nën sundimin romak, duke u koncentruar fillimisht në atë që konsiderohej si kontribut i Romës, e që ishin pacifikimi i territorit dhe vendosja e mekanizmave të nevojshme për ruajtjen afatgjate të saj, por edhe sjellja e një mjedisi të ri politik, material dhe kulturore për një pjesë të popullatës së pushtuar. Pastaj, si hap të dytë, pasqyrimin e reagimit të popullatës indigjene ndaj këtij fenomeni.

Shkalla e përhapjes së qytetarisë romake, municipalizimi, rrjeti rrugor, minierat,

centurimi dhe kadastrimi i territorit, prania e ushtrisë, vilave dhe ekzistenca e latifondeve, urbanizimi dhe format e planifikimit të qyteteve, mbishkrimet latine, emrat, kultet dhe ritet funerale etj. të dëshmuara shpesh në të njëjtën kohë, me raste me nuanca, shërbejnë si evidenca që një komunitet lokal të cilësohet, apo jo, i romanizuar/akulturuar, dhe në të njëjtën kohë, dëshmojnë edhe suksesin e Romes në procesin e akulturimit të popullsive indigjene.

Përdorimi i termit romanizimi/akulturim për të përshkruar në mënyrë të përgjithësuar fenomene të ndryshueshme sipas periudhave, tematikave, vendeve, mjediseve, rrethanave dhe metodave është bukur i vështirë kur kihet parasysh fakti se burimet, qasjet dhe konkluzionet e arkeologëve, epigrafistëve, numizmatëve, filologëve ndryshojnë. Kësisoj, në rajone dhe mjedise të catktuara shoqërore, romanizimi/akulturimi preku aq thellë shoqëritë indigjene sa që ato u asimiluan plotësisht, sikundër që në shoqëri të caktuar ishte thjeshtë një proces ndryshimi kulturor i karakterit kryesisht superstrukturor, që çoi në pranimin e praktikave kulturore romake si dhe në depërtimin dhe përhapjen e strukturave sociale romake brenda tyre, por pa arritur ato përmasa sa për tu përcaktuar si asimilim apo akulturim.

Dardania, duke qenë pjesë e Perandorisë Romake për një kohë të gjatë, iu nënshtrua pashmangshëm tërësisë së ndryshimeve politike, socio-kulturore dhe ekonomike. Megjithatë, evidencat arkeologjike dhe ato epigrafike të deritanishme dëshmojnë se procesi i akulturimit preku kryesisht elitat e popullsisë së Dardanisë. Romanizimi/akulturimi në Dardani, nuk arriti ato përmasa sa për t'u përcaktuar

si akulturim apo asimilim i tërësishëm i shoqërisë dardane. Atë duhet shikuar më shumë në kontekst të përhapjes së formave dhe rregullave të reja të jetesës, të cilat shndërruan shkallë-shkallë, me shumë sipërfaqësisht se sa thellësisht, në të shumtën e rasteve, strukturat tradicionale të shoqërisë dardane. Në këtë këndvështrim duhet trajtuar edhe shkallën e romanizimit/akulturimit në Dardani, i cili u shoqërua edhe me forma të ndryshme qëndrese kundër këtij fenomeni nga kategori të ndryshme sociale të popullsisë dardane.

5. Prej konceptit teorik te realiteti pedagogjik apo anasjelltas? - diskutim mbi “antropologjinë e dy/katër fushave”

Prof. Ass. Dr. Arsim Canolli

Në këtë prezantim u diskutua mbi historinë e antropologjisë si program edukues, duke marrë parasysh hullinë teorike dhe praktike të Franz Boas-it, atë të antropologjisë së katër fushave, në kontekst të realitetit pedagogjik në Departamentin e Antropologjisë, ku antropologjia ligjërohet si program i dy fushave: antropologjisë kulturore dhe arkeologjisë.

Antropologjia e konceptuar nga Boasi, që njihet edhe si antropologji e katër fushave (antropologjia biologjike/fizike, antropologjia kulturore, antropologjia linguistike dhe arkeologjia), ka pasur sfida në kontekstin pedagogjik prej filleve të saj. Në kontekstin amerikan, Boas-i ka qenë themelues i antropologjisë si disiplinë pedagogjike. Kësisoj, legacia e antropologjisë së përbërë nga katër shtylla apo fusha është ende prezente në SHBA dhe gjetiu, por konverzacioni mes këtyre fushave nuk është krejtësisht i rrjedhshëm, për faktin se kemi të bëjmë me metoda e qasje mjaft të ndryshme. Një pamje më e ngjeshur interpretuese do të nxirrte në pah se antropologjia sot asociohet më shumë me antropologjinë sociale ose antropologjinë kulturore sesa me antropologjinë e modelit të katër fushave. Për shembull, arkeologjia shihet si shkencë më vete. Po ashtu, antropologjia fizike ka zhvilluar metodat e teknikat, por edhe pyetjet e veta mjaft unike, sa që rri më afër biologjisë sesa antropologjisë kulturore. Nëse duam të bëjmë karakterizim të thjeshtëzuar, atëherë fjala antropologji, në kontekstin publik ende kuptohet në tri mënyra: “studim mbi ekzotiken”, “studim i traditës” ose “studim i kafkave”. Në fakt, fjala “antropologji” është ndër konceptet më përndjellëse për sqarime shtesë, kur përdoret në aspektin historik, por edhe

atë qasësor.

Në kontekstin historik pedagogjik, antropologjia holistike apo antropologjia boasiane, pati sfida të mëdha. Ndonëse kishte vazhduar programi boasian, në realitet, pakkush kishte interesim dhe mundësi reale të merrej me të gjitha fushat e antropologjisë. Në fakt, nuk është e mundshme të jesh specialist në secilën prej tyre, sepse secila ka nën-fusha e zgjatime tematike, interdisiplinare, sa që horizonti i “antropologjisë së...” (thënë kushtimisht “...diçkasë”, si p.sh. “antropologji e modernitetit”, “antropologji e bukës”, “antropologji digjitale”, etj.) është i madh. Në kontekst të interdisiplinaritetit, duket se më shumë afrohen disiplinat brenda spektrit të shkencave shoqërore e dijeve humane me antropologjinë sociale, sesa antropologjia sociale me arkeologjinë apo antropologjinë biologjike. Pra, ka dallime mes arkeologjisë, antropologjisë kulturore, antropologjisë biologjike dhe asaj linguistike dhe ato janë të dukshme si në metoda ashtu edhe në qasje. Por, ka edhe afërsi unike, si vrojtimi prej së afërmi i sjelljes e kulturës.

Megjithatë, ajo që mund të konsiderohet se është trashëgimi e antropologjisë gjithëpërfshirëse, dhe që mund të jetë esencialisht mjaft frytdhënëse, gjithnjë në kontekst të realitetit pedagogjik, është “faza nistore” e qasjes boasiane: secili antropolog duhet të njihet me “hyrjet” në katër fushat e antropologjisë. [Dhe, kjo qasje nuk është nisur konceptualisht nga Boasi, por si thekson Dan Hicks (2013), nga Pitt Rivers, dekada më herët.]

Pos SHBA-ve, edhe në departamentet e antropologjisë në Evropën Perëndimore, studentëve u ofrohet një hyrje në katër fushat, në vitin e parë e të dytë të studimeve.

Në kudoër të diskutimit mbi an-

tropologjinë si program pedagogjik në Departamentin e Antropologjisë (UP), u theksua se ekzistojnë dy programe, antropologji kulturore dhe arkeologji, por studentëve u ofrohet një njohje më e gjerë themelore, ku përfshihet antropologjia linguistike dhe historia.

Ajo që u nënvizua në kumtesë është fakti se programit pedagogjik i mungon një lëndë obligative mbi “antropologjinë biologjike/fizike”, që të plotësojë “fazë nistore” për antropologjinë gjithëpërfshirëse si program pedagogjik. Kjo do të ndihmonte studentët për të pasur një pamje themelore të ideve kryesore të zhvilluara në antropologjinë holistike, synimin për të njohur e diskutuar hullitë kryesore të interpretimit të diversitetit kulturor. Se si do të zhvillohet antropologjia në Kosovë, mbetet për t’u parë, por duket se në Departamentin e Antropologjisë, ideja e antropologjisë së katër fushave ka nisur të krijojë argumentin pedagogjik, fillimisht me dy fusha (antropologjinë kulturore dhe arkeologjinë), edhe në kontekst të interdisiplinaritetit edhe në kontekst të partikularitetit historik.

6. Vizualja në antropologji

MA. Ass. Zanita Halimi


Filmi dhe video, fotografia dhe multimedia digjitale janë duke luajtur rol të rëndësishëm në kërkim, janë thelbësore si mjete për orë mësimore, shpesh përdoren në kontekste të aplikuara. Përfaqësimet vizuale u ofrojnë shikuesve një mjet për të provuar dhe kuptuar kompleksitetin etnografik, pasurinë dhe thellësinë, të cilat janë tiparet dalluese të njohurive antropologjike. Media vizuale mund të përcjellin forma të njohurive që shkrimi nuk mund. Për më tepër, përmbajtja e mediave vizuale në antropologji bazohet domosdoshmërisht në hulumtime: efektiviteti i saj vlerësohet nga teknikat e njohura të kërkimit, duke përfshirë angazhime etnografike afatgjata, intervista dhe vëzhgim të pjesëmarrësve.

Studiuesitë Morphy dhe Banks tregojnë se cilat aktivitetet përfshihen në antropologjinë vizuale. Ata përmendin në një rëndësi anë antropologjinë vizuale që studion format e dukshme kulturore dhe, në anë tjetër antropologjinë vizuale, që përdor mediat vizuale për të përshkruar dhe analizuar kulturën.

Tani, më shumë se kurrë më parë, antropologët kulturorë janë duke përdorur imazhet vizuale në letër, forma digjitale, ose edhe forma të tjera të teknologjisë moderne, gjithnjë për të hulumtuar dhe për të paraqitur kulturat, jetën dhe përvojat e njerëzve të tjerë, të kulturave të ndryshme. Shpikjet teorike dhe inovacionet teknologjike kanë bërë pamjet vizuale të pranueshme, ashtu edhe

të kuptueshme për antropologët dhe kjo ka krijuar një kontekst bashkëkohor të zhvillimit gjithnjë e më të ngritur të metodave të reja të hulumtimit etnografik.


Së pari, fotografitë kanë shërbyer si një fletore. Shfrytëzimi dhe përdorimi i vizuales si kujtesë, si ilustrim dhe si dëshmi për përshkrime etnografike janë dukuri të zakonshme dhe të preferuara në Antropologjinë Kulturore. Në këtë rast i referohemi autorëve Bronislaw Malinowski, Young, Claude Levi-Strauss, dhe Margaret Mead, të cilët theksojnë dhe spikasin marrëdhënien, ose raportin ndërmjet fotografisë dhe të kujtesës, dhe, në shkrimet e tyre flasin për përdorimin e fotografisë gjatë punës së tyre në terren. Shpjegimet e teoricentëve na mësojnë se duke përdorë fotografinë si intervistë, antropologu ndihmohet të kuptojë realitetin në mënyrë të re. Studiuesitë theksojnë se aparati fotografik dhe mjetet e tjera të dokumentimit janë shumë me vlerë sepse ato mund të na pajisin neve me material, i cili mund të rianalizohet vazhdimisht me mjete më të mira dhe teori të zhvilluara.



Një monografi nga fusha e muzeologjisë

Së fundi, ka dalë nga botimi studimi i muzeologut dhe antropologut të kulturës, Valon Shkodra (doktorant në Universitetin e Lubjanës/ Departamenti i Etnologjisë dhe Antropologjisë Kulturore). Libri vjen si monografi për muzeun etnologjik “Emin Gjiku” në Prishtinë, ku trajtohet historia e muzeut, ekspozita e konstruktuar në vitin 2006, aktivitetet dhe ngjarjet e ndryshme kulturore, të realizuara aty dhe aspekte të tjera të funksionit dhe performancës muzeale. Shkodra punon në Institutin Albanologjik si bashkëpunëtor shkencor dhe është duke studiuar aspekte të trashëgimisë kulturore të Kosovës, në kuadër të projektit të doktoratës së tij. Libri është botuar nga Instituti Albanologjik i Prishtinës.

Libri ofron një pamje specifike studimore mbi muzeun, institucionet kulturore dhe trashëgiminë kulturore të Kosovës. Si i tillë, libri është burim i nevojshëm i literaturës për studentët e Departamentit të Antropologjisë.



Një përkthim i ri në fushën e primatologjisë dhe antropologjisë

Çfarë e bën qenien njerëzore specien më të sukseshme në botën e kafshëve? Shumica e shkencëtarëve pajtohen se çelësi i suksesit tonë është truri i madh. Në këtë libër, antropologu dhe biologu amerikan, Craig Stanford-i, jep një përgjigje të thukët ndaj kësaj pyetjeje të madhe, një përgjigje të bazuar në vërtetimet e tij shteghapëse shkencore. Sipas tij, mishi e ka bërë njeriun qenie unike, gjegjësisht gjahu për mish dhe shpërndarja e mishit. Ai bazohet në studimet e reja mbi sjelljen e shimpanzeve dhe majmunëve të tjerë antropoidë, “kushërinjve” tanë të lashtë hominidë, që nuk ekzistojnë më, dhe shoqërive njerëzore të sotme gjahtarë-mbledhëse, që ende ekzistojnë.

Craig Stanford-i është profesor i antropologjisë dhe biologjisë dhe bashkëdrejtues i Qendrës Hulumtuese Jane Goodall në Universitetin e Kalifornisë Jugore. Ka kryer hulumtime të gjata mbi majmunët dhe kafshët tjera. Ka shkruar dhjetëra libra dhe qindra artikuj shkencorë. Ky është libri i tij i dytë i botuar më 1999, ndërsa libri i tij i fundit është “The New Chimpanzee: A Twenty-First-Century Portrait of Our Closest Kin” (2018).

Libri është përkthyer në gjuhën shqipe nga Arsim Canolli, profesor i antropologjisë kulturore në Departamentin e Antropologjisë.

Traditë e kujtesë rreth e qark Manastirit të Deçanit

Çlirimtare Januzaj

(studente e antropologjisë kulturore)

Si mund ta identifikojmë kulturalisht sot vendin ku ndodhet Manastiri ortodoks-serb në komunën e Deçanit? A ia vlen të identifikohet e t'i vihet detyrimisht një emër?

Vend i diversitetit kulturor në të kaluarën, apo vetëm i një linje kulturore?

Cilat janë ato copëza të vetëdijes kolektive, që sot tregojnë brumin e fakteve të ekzistuar më parë, e që vazhdojnë të ekzistojnë edhe sot në popull?

Sa dhe si mund të shihet ajo panoramë nga ne sot?

Këto janë ca pyetje kryesore hulumtuese që kam parashtruar për një studim, që këtu po e jap të shkurtuar dhe në formë publicistike. Prapa këtij shkrimi ekzistojnë shume intervista. Pak e hiç literaturë, meqenëse nuk janë bërë hulumtime më herët të këtij lloji. Pas intervistave që i kam realizuar gjatë muajve mars-qershor, lidhur me Manastirin e Deçanit në përgjithësi, e që rezultuan me shumë informacione, une në fund vendosa që tema ime të ketë fokusin kryesor vetëm në një aspekt: Rituale të praktikuar në Manastirin e Deçanit "dikur". Jam munduar pak a shumë të nxjerrë diçka nga informantët lidhur me këtë temë, mirëpo është temë që ende duhet të shtrohet e diskutohet "*hollë e gatë*". Rituale, festa, përbirime, organizime madhështore, e shumë fjalë të tjera janë fjalë kyçe që më kanë përcjellë gjatë këtij hulumtimi. Rituale janë tërësia e riteve që bëhen në një ceremoni fetare apo thënë më qartë ritualet janë ato tërësi të veprimeve që bëhen në mënyrë të rregullt dhe të pandryshueshme për një periudhë të gjatë kohore, e që përcillen brez pas brezi. Manastiri i Deçanit sot konsiderohet si manastir ortodoks-serb, thuhet që është rindërtuar mbi themelet e një kishe ilire, në shekullin XIV nga Shën Stefani. Ky Manastir gjendet në Grykën e Deçanit, nën shpatet e mprehta të Bjeshkëve të Nemuna.

*"Me këtë mund të thuhet se gjatë mesjetës, edhe para ndërtimit të kishave mesjetare serbe, ka pasur kisha e faltore ilire të ritit ortodoks greko-bizantin e romak. Kisha të tilla paleobizantine ka pasur shumë në Dardani (Kosovë e sotme) sidomos në Rrafshin e Dukagjinit të sotëm, të ndërtuara në shekujt IV-VI të epokës sonë."*¹

Në oborret e Manastirit mbahen mend mirë festat e ritualet. Më i freskëti kujtim, i vetëdijes popullore është shënimi i ditës së Gospogjinit.² Informanti i parë dhe më i afërt, babai im, Miftar Januzaj 60 vjeçar, i kujton fort mirë vitet e 60-ta dhe 70-ta, ku shkollat i dërgonin me 27-28 gusht të festonin Ditën e Gospogjinit aty:

"Ditë e nxehtë gushti ka qenë kur kem shku krejt fmitë bashkë na kanë çu dej te Manastiri atje nelt, edhe pse un' e kisha afër ktu prej shpije me shku, po kisha qef me shku me shoqni. Kur shkojshim aty u bojke mirë, se ka pas njerz' prej kahmosit. Festojshim, hajshim e pijshim çka t'dush ki pasë. Muzikë, kangë e valle, bile edhe na shtijshin me u përbiru te varri aty mrena" thotë ai.

"Na shtijshin mrena me ren, për me hi nër varr e me dalë kah ana tjetër, na thojshin që na bon mirë. Ai varri u konë krejt i ngrit kshu, - varri i Stefan Decanskit m'doket, kom qenë fmi nuk e mbaj fort mirë nëmen historinë e tij çka na thojshin... Dojshin veç me promovu në qat ditë, me promovu kulturën e festat e tyne. Na merrshin neve fminive me shkoll e na qojshin", thotë Fadili, një informant tjetër i zonës.

Ndërsa, profesori Nezir Dabiqaj thotë se e mban mend shumë pak se si kanë shku edhe kanë marrë pjesë me plot të tjerë. *"Aty njerzt knojshin, hanin e pinin, i maj nëmen ka pasë edhe njerz me tesha kombëtare. Jashtë manastirit, ka pasë njerzë me tezga që shitshin gjithçka gjithçka, bile u bojke edhe kandi i lojnave, se lojna në Deçan nuk ka pasë në atë kohë"*. Sipas informantëve përbirimi bëhej për arsye të ndryshme. Njerëzit vinin nga të gjitha anët sepse shpresonin që varri i lartëpërmendur shëron sëmundje. Aty kanë ardhur gra të cilat nuk kanë mundur të mbesin shtatzënë, fëmijë që nuk flasin, apo njerëz që kanë pasë ndonjë hall tjetër. Përbirimi i varrit më kujton mirë ditën e Shën Gjergjit e mbajtur më 6 maj në Babaj të Bokës, Gjakovë, ku vitin e kaluar pata marrë pjesë personalisht tërë ditën, duke intervistuar e filmuar gjithë festën atje. Edhe ata përbiroheshin tek varri, silleshin, linin para për hir të shpirtit të Dervish Nezirit. Edhe aty ka pasë njerëz prej "*kah mosi*". Gra shtatzëna, fëmijë që nuk flisnin e njerëz me probleme të tjera vinin edhe aty. Bënin praktika të ndryshme për hir "të shërimit".

2 Dita e Gospogjinit është festë ortodokse e cila festohet në gusht. Ortodoksët festojnë "Ditën e Zonjës së Bekuar".

3 Fjalë po ashtu e përdorur në popull që nënkupton "nga të gjitha anët"

1 Shih: Mark P Gjokaj, (2014) 'Vojvodët shqiptarë në manastiret e Kosovës' [https://www.albdreams.net/vojvodet-shqiptare-ne-manastiret-e-kosoves/ - lexuar më 20 gusht 2020]



Foto © Çlirimtare Januzaj

E njëjta kronologji shfaqet edhe në Manastirin e Deçanit për ditën e Gospogjinit. Dy fe të ndryshme, dy vende të shenjta të ndryshme, njerëz me probleme të njëjta? Në përgjithësi njerëzit në rast të problemeve, janë të gatshëm të besojnë pothuajse në gjithçka, të binden lehtë. “Edhe n’guri nësë beson që ka me t’shnoshë, ka me t’shnoshë”, e kam dëgju këtë fjalë shpesh në terren. Mjafton që vendi të konsiderohet i shenjtë, që të besosh e të bindesh se të ndihmon në zgjidhjen e problemeve.

Gjatë festës së Gospogjinit, Gushavci⁴ ka qenë pika kryesore ku është frekuentuar nga njerëzit, pasi që është shumë afër Manastirit. Aty ka qenë “festa e vërtetë”; shumë njerëz, muzikë, lojëra, ushqime, pije. Ky aspekt nganjëherë më jep pështypjen se sapo njerëzit shohin se ka festë diku, shkojnë për t’u argëtuar, pa menduar për bindje fetare, apo diçka tjetër. Këtë fakt e kam vërejtë edhe në Babaj të Bokës, ku shumë njerëz vinin pa e ditur shkakun ose arsyen e festës, vetëm vinin për t’u argëtuar.

U kuptua që Dita e Gospogjinit lidhet vetëm me fenë ortodokse-serbe, por si ka mundësi që kjo festë të festohet edhe nga deçanasë, duke qenë shqiptarë dhe muslimanë? Ku qëndron qëllimi i dërgimit të nxënësve nga shkolla për në Manastir, për të festuar? Etnologu Betim Qorraj thotë se dita e Gospogjinit është ortodokse dhe do të mbetet ortodokse, nuk ka ndonjë lidhje me fenë muslimane. “Aty i kanë dërgu vetëm fëmijët më së shumti, arsyja e dërguarjes së tyre për të festuar ka qenë paksa e detyrueshme, sidomos ajo pjesa e përbirimit. Ndodh që fëmijët t’i kenë bërë ritualet e tyre pa vetëdije”, thotë ai. “Por, jo ndonjë musliman me vetëdije”.

Ky fakt më ka bërë të nuhasë pak komunizmin. Tregimet e babait dhe nanës kur kanë qenë gjimnazistë, flasin për dërguarjen e tyre me detyrim në aktivitete të ndryshme komuniste, në atë kohë. “Vijshin gjatë orëve të mësimi e na merrshin krejt nxënësit nëpër aktivitete të Partisë, shkemi pasë qare, jemi konë të detyrum”-thotë Miftar Januzaj. Qëllimi esencial i sistemit komunist ka qenë bindja e detyrueshme politike. E njëjta mund të qëndrojë edhe tek serbët-ortodoksë “bindje e detyrueshme fetare”.

Festa e rituale të tjera që nuk kanë lidhje me ditën e Gospogjinit, janë praktikuar gjithmonë nga shqiptarët në Manastir. Të paktën kështu thotë baca Idriz, plak 80 vjeçar:

“Qeshtu e kemi pasë traditë me shku për ner t’festave, si për fejesa e martesë e për gjithçka tjetër. Qashtu na kanë thanë, qashtu kemi ba. E kemi njëkë traditën.”

Ai ndjen mall e nostalgji për ato ditë; sipas tij, më herët kanë qenë të lirë të shkojnë e të kryejnë rituale nga më të ndryshmet për hir të festave, tash më nuk e kanë atë mundësi, meqenëse Manastiri i Deçanit është “fortifiku si kala”. Për çfarë festash të tjera e ritesh bëhet fjalë? Duke e lidhur këtë me faktin e lartpërmendur në fillim, që në lokacionin ku ndodhet sot manastiri, ka ekzistuar një kishë ilire, atëherë mund të ketë njëfarë sensi, që aty me të vërtetë mund të kenë ekzistuar kisha, faltore ilire. Mund të jenë praktikuar rituale pagane, që tani janë përcjellur brez pas

4 “Gushavci” thirret burimi i ujit mineral

brezi. Me shumicën e informantëve me të cilët kam folë e kanë mohuar faktin që Manastiri ka qenë gjithmonë serb, dhe që popullsia vendase aty ka qenë serbe. Ata besojnë që aty ka qenë kisha shqiptare dhe që ato troje ju takojnë deçanasve. Madje një banor i fshatit Isniq, Mehmet Bojku, thotë se gjyshërit e tij i kanë thënë që ata qysh herët kanë pasë tokë afër Manastirit. Disa të tjerë mendojnë që rreth Manastirit ka lokalitete të ndryshme arkeologjike që dëshmojnë autoktoninë e tyre. Po japim disa sosh:

“Ekziston edhe një dëshmi se ky vend banohej para shumë shekujsh. Në të njëjtin nivel me Kullën e Qelisë (afër Manastirit) ekzistojnë disa shpella të murosura, kurse në kilometrin e gjashtë nga Deçani, në anën e Bellesë, është një shpellë e cila siç duket, në lashtësi ka shërbyer sj faltore”.⁵

“Kësokohe u ndërtuan fortifikimet në Radac (të Pejës), në Dollc, Korishë (Kabash të Prizrenit), Harillaq, ndërsa në trevën e sotme të Deçanit, në fshatin Belle ishte ndërtuar Kisha e Shën Nikollës dhe fortifikimet e faltoret ilire të asaj kohe në këtë fshat të lashtë (tani s’ka banorë në të) që kanë mbetur gjurmët arkeologjike edhe sot e kësaj ditë, siç janë vizatimet e mbishkrimet në shpellat e shumta në terrenet e katundit të Bellesë, mandej Veku i Krajlicës dhe gjurmët e rrugëve dhe pikëvrojtiveve të këtyre anëve të përdorura aq shumë në kohën antike ilire-romake.⁶

“Në bazë të kujtesës historike të pleqnarëve të nahijeve të Gjakovës e të Pejës si dhe të dokumenteve të shkruara, mund të vërtetohet se vojvodët shqiptarë të kishave serbe në Kosovë i kanë mbrojtur këto monumente dhe institucionet e tyre fetare, jo vetëm për privilegjet e shumta që kanë pasur e për përfitimet materiale ose pagat vjetore a mujore, por vetëm për shkakun se këto kisha të ndërtuara në trojet e tyre, në patundshmërinë territoriale të tyre i kanë konsideruar si prona të vetat, si prona legjitime që nga kohët ilire, kur kanë qenë manastiret, faltoret e kishat paleokristiane në Kosovë, si dhe gjatë kohërave greko-romake, sllave e deri më sot.”

Ndoshta vendi ku ndodhet sot Manastiri i Deçanit nuk ka nevojë të identifikohet, ose nuk ka nevojë as t’i vihet emër, titulli apo pronari. Pavarësisht problemeve politike që kanë ndodhë e vazhdojnë të ndodhin, pavarësisht ndalesës dhe shtypjes së vlerave kulturore si pasojë e ndryshimit të sistemeve, në popull panorama e bjeshkëve të Deçanit përmbi

5 Rexhep Maksutaj, *Isniqi gjatë shekujve, vështrim antropologjik dhe kronikë ngjarjesh historike*, 2002
Libri shkollor, Prishtinë, fq.78

6 Shih: Mark P Gjokaj, (2014) ‘Vojvodët shqiptarë në manastiret e Kosovës’ [<https://www.albdreams.net/vojvodet-shqiptare-ne-manastiret-e-kosoves/> - lexuar më 20 shtator 2020]

7 Po aty




Foto © Çlirimtare Januzaj

Manastir gjithmonë do të konotojë e do të kujtohet si vend i traditës, i trashëguar nga të parët. Pavarësisht edhe transformimit kulturor që kane ndodhë ndër vite aty, nuk mund te mohohet fakti se kujtesa e historia gojore është ajo që mund të hedh dritë sadopak në mjegullinën e praktikave sociale e kulturore të paraardhësve.

Përvoja e mësimit online

(hulumtimin e realizuan: Shpat Shkodra, Diona Arifi, Diona Arifi, Era Draga, Valentina Krasniqi; përgatitur nga Arsim Canolli)

Gjatë vrullit të pandemisë, prej marsit (2020) deri më tani, kam menduar shpesh për mënyrën se si do të mund të praktikohet antropologjia si praktikë vrojtimi e hulumtimi, por edhe si qasje e teori, në kontekst të izolimit, pamundësisë së udhëtimit, distancës fizike e me radhë. Gjatë kësaj kohe, Daniel Miller, një prej antropologëve të mirënjohur të kulturës materiale (UCL, Londër), i cili së fundi ka bërë studime të thukëta të medieve sociale, bëri një video-ligjëratë, ku theksoi se etnografia mund të bëhet edhe “online” gjatë izolimit, edhe në formë digjitale, dhe mund të jetë origjinale dhe mjaft frytdhënëse, madje mund të japë edhe gjëra të reja, sepse njerëzit mund të jenë edhe më të hapur kur komunikojnë “online”. (Shih: <https://www.youtube.com/watch?v=NSiTrYB-Oso> - vendosur në Internet më 3 maj 2020). Miller ka argumentuar për një lloj mishërimi të digjitales në jetën reale sociale: në librin “*Interneti: një qasje etnografike*” (2000) të shkruar bashkë me Dan Slater, theksojnë se Interneti nuk është abstrakt dhe se, në fakt, Interneti nuk “është”, por “bëhet”, dhe bëhet social, politik e kulturor, duke u mishëruar si përvojë e praktikë në marrëdhëniet e njerzve mes veti, nga ata që e përdorin atë për qëllime, shprehje, dëshira e interesa të tyre. Pra, kjo teknologji e “thatë”, që kur shihet si formë duket pothuajse e “tëhuajëzuar”, objektivohet apo artikullohet në një formë shoqërore, kur përdoret si mjet social. Edhe studimet e fundit të tij mbi mediet sociale e pohojnë këtë argument.

Në kontekst të etnografisë përmes mjeteve digjitale si “webcam” e raste të tjera, del në pah pyetja tjetër: a mund të zëvendësojë komunikimi virtual gjithë kontekstin e komunikimit real, sy më sy, pranë trupit të informantit, pranë materialitetit të tij praktik, në rutinën e tij ditore? Pa dyshim se antropologët e digjitales, mund të argumentojnë rreth e qark përgjigjes, por pyetja ende mbetet kokëfortë. Këtu kemi të bëjmë me një çështje delikate që duhet të tërheqet në shqyrtim, sepse shpeshherë intervista si komunikim dialogues mes intervistuesit dhe të intervistuarit “etnografizohet”, ku vetëm narracioni i saj jepet si përmbatje e evidencës empirike të etnografit. Por, në antropologji, intervista është vetëm një nga metodat, apo mjetet e mbledhjes së evidencës e njohjes së temës, sepse etnografi duhet të shohë mes rreshtash, gjatë praktikës, në kontekst të ndryshimit, në raport me grupin, t’i vrotojë në interpretim të thukët kuptimet e shumta të një praktike a narracioni, t’i shoh ndryshimet e konfliktet në sferë më të gjerë të grupeve shoqërore, por edhe në kontekst historik. Si mund t’i hetojë ai këto nëse krejt puna e tij është “online”? Në anën tjetër, statusi i “performancës online”, apo i “sjelljes në mediet sociale”, por edhe funksioni, strukturimi, e shumë aspekte të tjera, janë bërë tema studimi ndër vite.

Pa dyshim se gjatë këtij viti, në revistat antropologjike, në simpoziume e konferenca, janë mbajtur shumë kumtesa e shkruar një sërë studimesh e konceptuar monografi mbi “sjelljen online gjatë pandemisë”, “afërsi sociale virtuale”, “izolim-


in në virtuale”, etj. Do të shkruhen shumë sosh edhe në të ardhmen, kur të njihet edhe më mirë kjo gjendje.

Në këtë shkrim nuk pretendohet ndonjë argument qenësor, as ndonjë etnografi substanciale e sjelljes online gjatë pandemisë. Këtu jepen disa dromca evidencash se si studentët e kanë përjetuar “mësimin online”. Jepen vetëm disa dromca përshtypjesh të dala nga intervistat e disa studentëve të vitit të dytë të antropologjisë kulturore me kolegët e tyre studentë në UP, të fushave të ndryshme. Krejt kjo është bërë për të evidentuar disa nga perceptimet e nxëna gjatë diskutimit mbi efektet që ka pasur e mund të ketë mësimi online gjatë kohë së izolimit për t’u mbrojtur nga pandemia, përkatësisht gjatë periudhës së shpërthimit mars – maj 2020.

Më 13 mars 2020, institucionet e qeverisë së Kosovës morën vendim që procesi mësimdhënës të vazhdojë përmes formave virtuale, përkatësisht përmes platformave të Google-it, *GoogleMeet* dhe *GoogleClassroom*. Gjatë kësaj kohe edhe profesorët dhe asistentët e Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”, filluan të përdorin këto teknologji digjitale për të vazhduar mësimin në kushte të izolimit nga pandemia COVID-19. Procesi i mësimit online nisi relativisht shpejt, përkatësisht me 15 mars. Pa dyshim, pati disa vonesa në hapjen e emailadresave zyrtare të studentëve, por gjatë javës së 15 marsit gjërat morën formën e tyre.

Më kujtohen gajasjet akademike me formën e mësimit online, përkatësisht me kurset diplomike ose postdiplomike “online”. Thuhej: “*e ka marrë një diplomë, këso online*”, duke nënkuptuar gjithnjë se një lloj studimi i tillë s’ka vlerë. Por, ra kjo pandemi dhe e pamë se gjërat kanë ndryshuar mjaft në perceptimin e mësimit e studimit online. Shprehia dhe rutina e bëjnë punën e vet dhe nuk i dihet, ndoshta “online” do të jetë forma e ardhshme e gjithë studimeve, një mundësi e re e hiper-interdisiplinaritetit të studimeve, ku studenti zgjedh kurse online, dhe përpilon vetë gjithë programin e tij studimor. Kjo do të shtronte shumë pyetje, që mund të orientojnë studime për “realitetin akademik virtual”: Si do të kombinohet me forma të tjera? Çfarë efekti do të ketë në emancipimin hulumtues/kërkues e intelektual kjo formë e re? A do të vlejë të njëjtit parametra në përcaktimin e statusit të mësimdhënësit universitar, etj? Si do të ndikojnë në jetën sociale studentore? A do të ndryshojë statusi i universitetit në shoqëri?

Kjo formë e mësimdhënies na shtyri të mendojmë për efektin e mësimdhënies, leximit e studimeve në përgjithësi. Sa do të jetë koncentrimi i duhur, si do të mbahen provimet, si do të realizohen diskutimet, sa do të ketë efekt kjo shpëputje virtuale nga mësimi zakonshëm etj? Secili nga kolegët profesorë, gjatë mbledhjeve të Departamentit, po ashtu të organizuara online, theksonte përvojën e vet virtuale: “shkoi mirë”, “fillova me diskutime”, “po ndalet rryma ngan-



jëherë”, etj. Vërehej një lloj gatishmërie për t’u ballafaquar edhe me këtë lloj forme të mësimdhënies, duke mos e lënë anash edhe drojën edhe faktin se çfarë do të bëhet në të ardhmën.

Pa stërtholluar shumë, do të rendisim disa nga argumentet kryesore që kanë dalur nga 20 intervista të realizuara nga 5 studentë: Shpat Shkodra, Era Draga, Diona Arifi, Diona Arifi dhe Valentina Krasniqi (studentë të vitit të dytë të programit antropologji kulturore).

Një student i intervistuar thekson:

“Avantazhet e këtij mësimi online janë se kam pasur më shumë kohë dhe jam fokusuar më shumë në punimet seminarike dhe ese, ndërsa diavantazhet sipas mendimit tim, janë sepse nuk të krijon të njëjtën ndjesi dhe përshtypje sikur të jesh në bankat e fakultetit, dhe poashtu, një ndër disavantazhet është edhe mundimi psikik që të krijon laptopi apo kompjuteri duke ndenjur pothuajse shumicën e kohës në të.”¹

Një student tjetër thekson se:

“Avantazhet e mësimi online, eksperiencë e re dhe metoda te reja, qasje në ligjëratë edhe me orar më vonë, p.sh. në ora 19:00 etj. ndërsa disavantazhet janë problemet që mund të hasen në internet (pamundësia e dikuajt që jeton në fshat me u kyç), nganjëherë zhurma, jehona, ndërpreja e zerit si pengesë për me e kuptu ligjëratën etj.”² Nga 20 intervista

të realizuara nga studentët, shumica e studentëve theksojnë se nuk i parapëlqejnë ligjëratat online, pos në disa raste të orëve shtesë apo ligjëratave mysafire. Një ndër disavantazhet më të theksuara nga këta studentë të intervistuar duket se ka qenë mundësia e manipulimit me pjesëmarrjen në ligjëratat online. Shpesh kur janë pyetur më shumë kanë theksuar se kanë marrë pjesë, por nuk kanë qëndruar të vëmendshëm, ose kanë dalur menjëherë, sikundër që kanë manipuluar me detyrat. Pra, studentët kanë theksuar faktin se ndonëse mësimi online mund të theksohet si “histori suksesi”, për kohën kur ka ndodhur, siç thekson D.B.,³ ata nuk do të preferonin që të mbahej mësimi online në të ardhmen. Dhe, këto mendime janë dhënë në muajin qershor, kur ata kanë pasur një përvojë 2 mujore e më shumë dhe kur masat kanë filluar të lehtësohen, sidomos lëvizja fizike publike. Pra, doemos vërehet një ndjenjë e kompensimit virtual të përvojës studentore si masë e përkohshme dhe specifike, sepse gjithmonë potencohet ideja e kthimit në normalitet.

Nga ana tjetër, mungesa e literaturës është e evidente, por edhe mungesa ose ndërprerja e internetit, zhurma dhe pengesa familjare, mërzia nga izolimi theksohen si disa nga vështirësitë kryesore gjatë pandemisë.

1 Intervistë e Era Dragës me A.A., student i shkencave politike (anonim/UP), realizuar në qershor 2020.

2 Intervistë e Diona & Diona Arifit me B.B., student i gazetarisë (anonim/UP), realizuar në qershor 2020

3 Intervistë e Valentina Krasniqit me D.B., studente e vitit të dytë (UP), realizuar në qershor 2020

Ka raste kur studentët theksojnë edhe faktin se nuk janë ndjerë të lirë të bëjnë pyetje, “sepse kemi hezituar për ta hapur mikrofonin, sepse mendonim që po e pengojmë profesorin/profesoreshën gjatë ligjërimit”.⁴

Por, ka edhe raste kur studentët ndjejnë se “mësimi online” ka profanizuar raportet profesorë/studentë dhe kjo është e mirëseardhur. Y.B., student i vitit të parë në fushën e dramaturgjisë në Fakultetin e Arteve, thekson një aspekt specifik të efikasitetit të ligjërimit online, që po e japim në formë më të plotë :

“Ajo pjesë ku ana sociale a komunikimit dhe bashkëbisedimit social, qysh sillen profesorët, qysh...ajo ka qenë ndryshe, ka mungu qajo pjesa ku kanë mujtë me përdor atë pjesë për anën e tyre të ligjërimit, ndërsa janë kanë të hequr prej qatij konforti, prej konfortit të qenurit të ditun të raportit profesor-student dhe dinamikat e rolit autoritativ...kjo e ka theksu anën racionale e teknike të kalimit të syllabusit e ligjërimit, kjoja ma të kuart e ma formal të ligjërimit, dhe ajo ka benefictonet e veta, sepse unë mendoj që në fakultet jo domosdoshmërisht duhet me shku me qato marrëdhëniet e lidhjet e dinamikave të raporteve dhe roleve të shoqërore, të cilat janë... po duhet me kanë thjeshtësisht dhe pastërtisht e bazume mes informatave të kuarta dhe formale, të cilat u jepen studentëve...ato raportet e dinamikave të roleve shoqërore duhet mu kalu në shkolla fillore e të mesme...raporti emocionale dhe i roleve sociale që mundet me u përdor në qat aspekt, ndoshta, e sabotojnë kualitetin e mësimi formal e universitar, që ish dashtë me kanë, dmth, rahatia dhe konforti i klasës dhe i ballafaqimit trup me trup mundet me u manipuliu edhe me pasë devijimi e mu shfrytëzu ajo prej profesorit që e ka anën qanej...e në këtë aspekt...ai formalitet që iu ka dashtë me krijë ka qenë goxha ma eficient, por kjo varet edhe prej landës në landë...mendoj që ish dashtë që goxha njëpjesë me u majtë online...ligjëratat online e praktika “live”...”⁵

Nga kjo pikëpamje, vërehet se aludohet se në UP ka edhe profesorë që ndjehen “komfort” gjatë ligjëratave, duke shfrytëzuar kohën për të hyrë në biseda jashtë temës së paraparë në syllabus. Kësisoj, vërehet se “mësimi online” është një lloj eskepizmi nga “komforti” i klasës fizike. Por, sa mund të jetë determinuese teknologjia “online” në profanizimin e përmendur të ligjërimit, është po ashtu pyetje që duhet bërë. Pa dyshim se kjo pikëpamje ngrit nevojën për diskutime mbi aspekte pedagogjike të ligjërimit dhe praktikës gjatë procesit mësimor, sidomos në UP.

Ka edhe raste kur studentët theksojnë mungesën e interesimit dhe neglizhencën me ligjëratat e ushtrime dhe theksojnë faktin se tejkalim i kësaj gjendjeje ka qenë pikërisht serioziteti i profesorëve.

“shumë mirë që u majt,...por prej asaj që kam mujtë me vërejtë është se ka qenë në dorën e profesorëve se sa po i majnë të angazhum studentat ...sepse kanë mujt veç me lëshu

kamerë....e kam vërejt se shumë prej studentëve i majshin kamerat nalun edhe mikrofonat... kështu që u kanë e domosdoshme prej profesorëve që me ba pyetje me i thirrë me emër...”⁶

Në disa raste, ideja e mungesës së shpenzimeve ka qenë avantazh, për faktin se studentët nuk kanë pasur nevojë të udhëtojnë deri në universitet, gjë që ka dhe shpenzimet tjera shtesë, pas daljes nga shtëpia. Por, shumica e studentëve që janë intervistuar (18 nga 20) kanë theksuar se i preferojnë ligjëratat në kampuse më shumë se sa online dhe se dëshirojnë që t'i kthehen normalitetit dhe të vijojnë ligjëratat e ushtrimet në kampuse. Ndonëse semestri i pranverës 2020 shihet si një “histori suksesi” dhe profesorët e UP-së vlerësohen për këtë, në përgjithësi, shumica duan që kjo të mos ndodh më. Krejt për dy fakte: mësimi online nuk stimulon studentin sikurse mësimi në klasë, sado që kanë kohë më shumë kur nuk lëvizin nga shtëpia, dhe mësimi online përjashton jetën sociale të studentëve, që ka peshë të madhe për ta.

Një aspekt tjetër që del në pah është fakti se puna praktike, sidomos ajo në arkeologji dhe antropologji kulturore, është esenciale dhe nuk mund të zëvendësohet përmes ligjëratave “online”. Pa dyshim se studentët mund të vizitojnë simulacione tredimensionale virtuale në uebfaqet e muzeve dhe linstitucioneve të tjera, por, si theksohet edhe nga vetë studentët, përvoja praktike që merret në terren, nuk mund të zëvendësohet me asnjë lloj simulacioni virtual.

Kështu, gjithë “komforti” i përmendur, mund të racionalizohet dhe “pastrohet” përmes “ligjërimit online”, por ky racionalizim mund ta zbehtë kureshtjen, inspirimin dhe efektin që ka studimi i zakonshëm në objekte të universitetit, në klasë reale.

Ky hulumtim krejt i shkurtër, i realizuar në kuadër të semestrit veror 2020, çon ujë në mulli të argumentit antropologjik se si qenie sociale, njerëzit kanë nevojë për shoqërim, socializim, jo vetëm virtual, por fizik. Virtualja ka peshë vetëm në kontekst të zgjatjes së reales, jo si zëvendësim i saj. Të paktën ende jo, por, gjërat edhe mund të ndërrojnë në të ardhmen.

4 Intervistë e Valentina Krasniqi me F.P., studente e UP-së, realizuar në qershor 2020

5 Intervistë e Shpat Shkodrës me Y.B, student i dramaturgjisë (UP), realizuar në qershor 2020

6 Intervistë e Shpat Shkodrës me M.M, studente e gjuhës angleze (UP), realizuar në qershor 2020

Tryezë e Departamentit

Departamenti i Antropologjisë
do të organizojë tryezën e dytë të departamentit me temën

“Antropologji e trashëgimisë kulturore: studimet, teoritë, qasjet, metodat”

E premte, 12 shkurt 2021
Salla 02, Kati 1, Fakulteti Filozofik

8.30 - 9.00 (kafe e mëngjesit)

9.00 - 10.30 (prezantime)

10.30 -10.45 (pauzë)

10.45 -12.00 (prezantime)

12.00 -12.30 (diskutim përmbyllës i panelit 1)

12.30- 14.00 (dreka)

14.00 -15.30 (prezantime)

15.30 -15.45 (pauzë)

15.45 -17.00 (prezantime)

17.00 -17.30 (diskutim përmbyllës i panelit 2)



Në tryezë do të paraqesin kumtesat e tyre ligjëruesit (e rregulltë dhe të angazhuar) të Departamentit të Antropologjisë dhe bashkëpunëtorët e ftuar nga Departamenti.

Rendi i plotë i ditës së tryezës do të bëhet i njohur para datës së tryezës.

Ligjëratë nderi **Prof. Dr. Edi Shukriu** **(ASHAK)**

Departamenti i Antropologjisë
organizon ligjëratë nderi dhe konverzacion me

Prof. Dr. Edi Shukriun

21 tetor 2020

ora: 11.00 - 12.00

Salla 14, Kati përdhesë, Fakulteti Filozofik



Prof. Dr. Edi Shukriu ka ligjëruar në Departamentin e Historisë, prej vitit 1979 deri në vitin 2014. Në Departamentin e Antropologjisë ajo ka ligjëruar prej vitit 2014 deri në qershor të vitit 2020.

Prof. Dr. Edi Shukriu i përket brezit të parë të arkeologëve të Kosovës, me përvojë prej pesë dekadash. Në këtë takim nderi me kolegë e studentë, ajo do të na nderojë me rrëfime për përvojën e saj si arkeologe, punën në terren, mësimdhënien dhe perspektivën e arkeologjisë në Kosovë.

Moderator: Prof. Ass. Dr. Arsim Canolli

Pas ligjëratës do të ketë një koktej rasti!
Mirë se vini!

**Departamenti i Antropologjisë ofron
studime të nivelit BA në antropologji
(180 ECTS kredite, 3 vjet)**

Studimet profilizohen në dy degë:

- a) antropologji kulturore**
- b) arkeologji**

**Viti i parë akademik është i përbashkët,
ndërsa në vitin e dytë studentët ndjekin
profilin e zgjedhur. Departamenti shquhet për mundësinë
që u jep studentëve në punë praktike dhe projekte
hulumtuese.**

**Për më shumë, lexoni doracakun për
studentë, në uebfaqen e Departamentit
të Antropologjisë**

<http://filozofiku.uni-pr.edu/Departamentet/Departamenti09.aspx>

**ose na shkruani në
antropologjia@uni-pr.edu**



Për arsye të pandemisë COVID -19, nuk kemi dashur të bëjmë planifikim vjetor të ligjëratave mysafire të Seminarit të Antropologjisë 2020-2021. Seminari do të mbahet, varësisht masave që merren nga institucionet shtetërore, qoftë si zakonisht në objekte të Fakultetit Filozofik, qoftë përmes platformave digjitale në Internet, qoftë në formë të kombinuar.

Informatat për secilën ligjëratë do të jepen disa ditë/një javë para mbajtjes së ligjëratës. Këto informata do të vendosen në uebfaqe të Departamentit dhe në medie sociale e gjetiu.

Për më shumë rreth Seminarit të Antropologjisë kontakto: arsim.canolli@uni-pr.edu dhe/ose arben.hajdari@uni-pr.edu

